RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

(Financiar)

Tiranë, shtator 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3 – 8**
1.	Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit....	3-4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	4-7
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	7-8
II.	**HYRJA**	**8 – 12**
1.	Objektivat dhe qëllimi	
2.	Identifikimi i çështjes.....	
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	
5.	Kriteret e vlerësimit.....	
5.	Standardet e auditimit.....	
7.	Metodat e auditimit.....	
8.	Dokumentimi i auditimit.....	
III	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	**12 - 47**
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	12-13
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	**13 - 47**
2.1	*Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.*	*13 – 24*
2.2	*Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.*	*24 – 33*
2.3	*Auditimi i llogarive vjetore për vitin 2025.*	*33 – 47*
IV	**REKOMANDIME**	**47 – 51**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. *Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim*.

Bashkia Dimal, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" , i ndryshuar dhe Ligji nr.68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" , i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Dimal për periudhën e aktivitetit financiar të vitit 2025, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e vijim KLSH), sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Buxheti i Bashkisë Dimal si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transferta e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transferta specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave kombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "*Për financat e qeverisjes vendore*", i ndryshuar, nenit 50 pikat 1 dhe 2.

Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Dimal si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave.

Për *auditimin financiar*, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2025 deri më datën 31.12.2025.

Objektivat e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit për periudhën objekt auditimi 01.01.2025 – 31.12.2025, janë si vijon:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik;

- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit;

-Auditimi i llogarive vjetore për vitin 2025.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. *Auditimi është kryer mbi bazë risku*. Grupi i auditimit ka audituar mbi 60% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 17,202 mijë lekë për vitin 2025.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: *Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm*.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- *Verifikimi i transaksioneve;*
- *Shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit;*
- *Intervistat;*
- *Verifikimi në sisteme dhe terrene, etj.*

e. *Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve*:

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar **11** gjetje dhe ka dhënë **12** rekomandime, *nga të cilat;* masa organizative 7 gjetje me 8 rekomandime dhe masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara 4 gjetje dhe 4 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Nga auditimi mbi funksionimin e ligjit për menaxhimin financiar rezultoi: Mungesa e trajnimit të stafit të bashkisë, mos miratimi të planeve vjetore të punës për funksionimin e GMS, mos miratimi i planit të përgjithshëm strategjik, mungesa e hartimit dhe miratimit të strategjisë së menaxhimit të riskut; mungesa e gjurmëve të auditimit për proceset e ndjekura- --Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Dimal përgjatë vitit 2025, u konstatua se:

-Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2025, nuk është hartuar plotësisht në përputhje me Urdhrin nr. 4, datë 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

-Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore.

-Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit.

-Në dosjet e auditimit të realizuar nga Njësia e Auditimit nuk është dokumentuar plani i veprimit, i cili duhet të realizohet nga subjekti i audituar në vazhdën e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit.

-Nga auditimi ka rezultuar se realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakordimit me degën e thesarit për periudhën objekt auditimi nga 991,952 mijë lekë të planifikuara është realizuar në vlerën 860,112 mijë lekë ose në masën 87 %, me mosrealizim në vlerën 131,840 mijë lekë, konstatohet se ka diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore për shpenzime operative në vlerën 35,175 mijë lekë *(planifikuar 158,927 mijë lekë janë realizuar 123,752 mijë lekë ose 78%)* dhe shpenzimet për investime në vlerën 76,309 mijë lekë *(planifikuar 357,688 mijë lekë janë realizuar 281,379 mijë lekë ose 79%)* kjo si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, realizimi i procedurave të prokurimit në fund të vitit lidhja e kontratave me vonesë dhe shpenzimeve operative të planifikuara, me ndikimin që ka në funksionimin dhe ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, rezulton se realizimi i tyre është më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit në tërësi.

-Nga auditimi ka rezultuar se detyrime për fatura të pa likuiduara dhe vendime gjykate të raportuara ne MFE në fund të vitit me shkresën nr. 794 Prot., datë 02.03.2026 “Mbi raportin e

monitorimit për 12/mujorin e vitit 2025", janë për vlerën 121,365,754 lekë *(shpenzime mirëmbajtje, shërbime e mallra në vlerën 46,753,969 lekë, shpenzime kapitale në vlerën 62,746,764 lekë dhe shpenzime gjyqësore në vlerën 11,865,021 lekë)* në raport me shpenzimet e kryera zënë 19.41% të tyre. Nga verifikimi i faturave të palikuiduara u konstatua se nuk është ndjekur radha e pagesës për 32 fatura në vlerën 76,280,605 lekë.

-Nga auditimi, konstatohet se llogaria 202 "Studime dhe projektime" në formatin Nr. 7/a paraqiten me koston historike në vlerën 77,716,016 lekë, e analizuar për 26 artikuj kontabël për studime e projektime. Nga verifikimi i inventarit kontabël u konstatua se në ketë llogari vlera prej 24,988,016 lekë i përket periudhave 2006-2009 për të cilat nuk ka dokumentacion për regjistrimin e saj në kontabilitet si dhe nuk ka informacion nëse ato janë vënë në zbatim për tu sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit, për pasojë në këtë rast pasqyrat financiare nuk e pasqyrojnë saktë vlerat e AAM, me ndikim në informacionin kontabël të tyre për efekt të llogaritjes së amortizimit.

-Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione" sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,385,435,367 lekë (viti 2024: 1,127,645,422 lekë). Referuar analizës së inventarit kontabël u konstatua se në fund të vitit vlera për 3 raste të investimeve të përfunduara në vitin ushtrimor me objekt "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara" në shumën 51,011,257 lekë është paraqitur si inventarë i Bashkisë, gjithashtu në këtë llogari nuk është zbritur vlera për 8 ndërtesa ambulanca në fshatrat Gorçan, Pashalli, Vokopolë, Skrevanj, Bistrovicë, Agim, Konizbalte dhe Hinke në vlerën 9,415,294 lekë që janë objekte të cilat i përkasin DRSHSH duke mbivlerësuar llogarinë 212 "Ndërtesa e konstruksione" për vlerën 60,426,551 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit.

-Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 2,495,873,577 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël u konstatua se, nuk është zbritur vlera për 7 objekte për ujësjellës-kanalizimeve në shumën 400,430,489 lekë që duheshin transferuar Ujësjellës Kanalizime, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit.

-Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve Drejtoria e Taksave dhe Sektori Borxhit edhe pse ka zbatuar përcaktimet në Kreun XI "*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, konstatohet se në fund të periudhës janë debitorë progresiv 117 subjekte për vlerën 40,247,940 lekë *(nga kjo debitorë të vitit 2025 janë shtuar për vlerën 5,097,008 lekë)* të dhënat në pasqyrën Aneks nr. 2, bashkëlidhur dhe debitorë progresiv familjarë janë 4595 familje për vlerën 225,504,530 lekë *(nga kjo debitorë të vitit 2025 janë shtuar për vlerën 46,823,854 lekë)*, pra debitorët gjithsej në fund të periudhës të kontabilizuar janë për vlerën 265,752,470 lekë, **nga e cila vlera prej 51,920,862 lekë** janë debitorë të vitit 2025 **të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë**

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me pagesën e detyrimeve për qira të tokave bujqësore rezultoi se Drejtoria e Taksave dhe Sektori Borxhit edhe pse ka zbatuar përcaktimet e kushteve të kontratave të lidhura për dhënien e tokave me qira dhe mënyrën e likuidimit të tyre rezulton se në fillim të vitit 2025 debitorë kanë qenë për vlerën 14,439,742 lekë për gjatë vitit 2025 nuk kanë likuiduar detyrimet në shumën 2,511,742 lekë dhe janë arkëtuar detyrime ë vlerën 566,568 lekë, pra debitorët për dhënien e tokave me qira progresiv në fund të periudhës të kontabilizuar janë për **39 kontrata qiraje** në vlerën 16,384,916 lekë, **nga e cila**

vlera prej 2,511,742 lekë shtuar gjatë vitit 2025 **janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.**

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, Drejtoria e Taksave dhe Sektori Borxhit edhe pse ka zbatuar përcaktimet ligjore të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 3/c, rezulton se në fillim të vitit 2025 debitorë kanë qenë për vlerën 5,516,143 lekë për gjatë vitit 2025 nuk kanë likuiduar detyrimet në shumën 3,980,449 lekë dhe janë arkëtuar detyrime ë vlerën 3,234,277 lekë, pra debitorët progresiv gjithsej në fund të periudhës të kontabilizuar janë për **219 objekte të personave** në vlerën 6,262,316 lekë, **nga e cila vlera prej 3,980,449 lekë** shtuar gjatë vitit 2025 **janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.**

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dizpozicion në lidhje me pagesën e detyrimeve për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, Drejtoria e Taksave dhe Sektori Borxhit edhe pse ka zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 35, të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar, rezultoi nuk kanë likuiduar detyrimet subjekti "D.O." ShPK në vlerën 800,000 lekë, subjekti "A." ShPK në vlerën 1,000,000 lekë dhe subjekti "2. Sh." Poshnje në vlerën 400,000 lekë, gjithsej **në vlerën 2,200,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë.**

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

-Titullari i njësisë vendore për mirëfunksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të marrë masa si vijon:

-Të hartohet një plan trajnimesh për punonjësit e këtij institucioni;

- Të hartohet dhe miratohet Plani Strategjik i institucionit;

- Të hartohet dhe miratohet strategjia e menaxhimit të riskut;

- Të miratohet Gjurma e Auditimit për institucionin.

-Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa:

-Për çeljen manualisht dhe elektronikisht të dosjeve të përhershme të auditimit të sektorëve dhe drejtorive të institucionit.

-Të arkivojë dosjet e auditimit në përfundim të çdo misioni auditimi në arkivin e institucionit.

-Bashkia Dimal nëpërmjet strukturave përgjegjëse, gjatë hartimit të buxhetit vjetor dhe programeve buxhetore afatmesëm, të bazohet në parashikimet realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të vitit të mëparshëm, duke pasur në konsideratë mosrealizimin e të ardhurave dhe analizimin e faktorëve që kanë ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve, kryesisht të shpenzimeve operative dhe ato për investime.

- Drejtoria e Ekonomisë Financës dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Dimal të marrë masa për të paraqitur në mbledhjen e Këshillit Bashkiak një material të detajuar mbi gjendjen aktuale të faturave të palikuiduara, në vlerën prej 121,365,754 lekë. Gjithashtu, të hartojë një plan për likuidimin e këtyre detyrimeve, duke respektuar rendin kronologjik të pagesave, me përparësi për detyrimet e krijuara përpara vitit buxhetor, me qellim shmangien e kostove shtesë për buxhetin, të shkaktuara nga vonesat në pagesa.

-Drejtoria e Ekonomisë Financës dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Dimal të marrë masa për kryerjen e sistemimeve kontabël në lidhje me pasqyrimin si pjesë të AAMGJ të të gjithë elementëve të tyre përfshirë dhe vlerën e studim projektimeve.
-Drejtoria e Ekonomisë Financës dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Dimal të marrë masa për kryerjen e sistemimeve kontabël duke zbritur vlerën e investimeve për objekte që nuk janë inventarë i saj në shumën 51,011,257 lekë.
- Bashkia Dimal, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për transferimin në DRSHSH të 8 artikujve kontabël ndërtesa pjesë e inventarit me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur vlerën 9,415,294 lekë.
- Bashkia Dimal, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për transferimin në shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" sh.a të 7artikujve kontabël pjesë e inventarit me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur vlerën 400,430,489 lekë.
- Drejtoria e Taksave dhe Sektori i Borxhit, Bashkia Dimal të marrë masa për zbatimin procedurat ligjore për arkëtimin e debitorëve progresiv për taksa e tarifa vendore për 117 subjekte të biznesit të madh e të vogël dhe për 4595 familje, me vlerë 265,752,470 lekë.
- Bashkia Dimal nëpërmjet Drejtoria e Taksave dhe Sektori i Borxhit dhe Drejtorisë Juridike, të marrë masa për zbatimin procedurat ligjore për arkëtimin e debitorëve progresiv për dhënie me qira toka bujqësore, për 39 kontrata qiraje me vlerë 16,384,916 lekë.
- Drejtoria e Taksave dhe Sektori i Borxhit, Bashkia Dimal, të marrë masa për zbatimin procedurat ligjore për arkëtimin e debitorëve progresiv për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit për 219 persona me vlerë 6,262,316 lekë.
-Drejtoria e Taksave dhe Sektori i Borxhit, Bashkia Dimal, të marrë masa për zbatimin procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara për pajisjen me Autorizim/Liçensë për shitje karburanti nga 3 subjekte të vlerës 2,200,000 lekë.

I.1. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT.

I. Opinioni i auditivit mbi pasqyrat financiare:

Grupi i auditivit të KLSH-së, ka auditor pasqyrat financiare të Bashkisë Dimal për periudhën ushtrimore 01.01.2025 – 31.12.2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Dimal nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një ***opinioni të kualifikuar me rezervë****.*

Baza për opinionin e kualifikuar[1], me rezervë:

[1] Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 "Për miratimin e manualit të auditimit financiar " të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (faqe 54 dhe 60-61), "Një "Opinion i Kualifikuar me rezervë", jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë*;

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga njësia shpenzuese Bashkia Dimal, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (SNA- 700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 është 17,202 mijë lekë.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë parregullsitë në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2025, si më poshtë:

- Në llogarinë 202 "Studime e projektime", u konstatua se në inventarët e saj vlera prej 24,988,016 lekë është e paanalizuar me projekte.
- Në inventarin e llogarisë 212 "Ndërtesa e Konstruksione", u konstatua se në fund të vitit vlera për 3 raste të investimeve të përfunduara në vitin ushtrimor me objekt "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara" në shumën 51,011,257 lekë është paraqitur si inventarë i Bashkisë, gjithashtu në këtë llogari nuk është zbritur vlera për 8 ndërtesa ambulanca në fshatrat Gorçan, Pashalli, Vokopolë, Skrevanj, Bistrovicë, Agim, Konizbalte dhe Hinke në vlerën 9,415,294 lekë që janë objekte të cilat i përkasin Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Berat duke mbivlerësuar llogarinë 212 "Ndërtesa e konstruksione" për vlerën 60,426,551 lekë.
- Llogaria 213 "rrugë, rrjete, vepra ujore" në inventarin kontabël ka të përfshirë 7 aktive të llojit ujësjellës kanalizime në vlerën kontabël 400,430,489 lekë, të cilët duhet të ishin transferuar në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sh A.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" , i ndryshuar, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 546/1 prot., datë 22.05.2026 "*Auditim financiar*", miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Dimal nga data 26.05.2026 deri në datën 09.07.2026, u krye auditimi për periudhën nga data 01.01.2025 deri në datën 31.12.2025 nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. Z. P. Gj., *përgjegjës grupi;*
2. Zj. A. B., *anëtar;*
3. Zj. Sh.H., *anëtar;*

1. OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

- ***Objektivat dhe Qëllimi i auditimit.*** Objektivi i *auditimit financiar* është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2025, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

- Identifikimi i çështjes. Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë

subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.
Projekt Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.
Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditivit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i adituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditivi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditiv, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë.
- ***Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.*** Strukturat drejtuese të Bashkisë, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*", i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, etj.
- ***Përgjegjësitë e audituesve*.** Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.
Përgjegjësia jonë (*audituesit e KLSH-së*), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet me opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:
- *Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;*
- *Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;*
- *Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;*
- *Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;*
- *Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).*
- *Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;*

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Dimal, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

- *Kriteret e vlerësimit.* Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";* Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar*;* Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar; Ligji nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar*;* Ligji nr. 68/2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik",* i ndryshuar, etj.

Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"; Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde te monitorimit te buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore"; Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.02.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", i ndryshuar; Udhëzimet standarde vjetore të Ministrisë së Financave për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit, etj.

- Rregullore e Brendshme *"Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ KLSH-së",* miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 197, datë 12.10.2022, i ndryshuar; Rregullore e brendshme *"Mbi Procedurat e auditimit në KLSH", miratuar me vendimin nr.07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH-së*; Rregullore mbi organizimin e funksionimin e Bashkisë, etj. Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut; Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

- ***Standardet e auditimit.***

ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 "*Udhëzues të auditimit financiar*"; ISSAI 2300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*"; INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi standardet e kontrollit të brendshëm për sektorin publik"* si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*"; si dhe ISSAI 4200 "*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*"; INTOSAI "*Për implementimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit, ISSAI mbi auditimin e përputhshmërisë*"; etj. Standardet kombëtare të kontabilitetit; Standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i auditimit të brendshëm, etj. Standardet ndërkombëtare të auditimit mbi raportimin e audituesit të pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

- ***Metodat e auditimit.***

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- *Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe*
- *Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit*.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin: Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit*:*

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatohet se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese,* konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.
- *Kontrolli i vlerësimeve.* Përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmimi nga të tretët.* Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.
- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- *Intervista*
- *Raporte dhe Informacione*
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK.*

- Dokumentimi i auditimit.

Mbi bazën e pyetësorëve dhe testeve përkatëse të miratuara në manualet e auditimit financiar, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartua Projekt Raporti i Auditimit i cili u dërgua Subjektit me shkresë nr. 546/2, datë 21.07.2026. Nga subjekti i audituar me shkresën nr. 1522/8, datë 20.08.2026 të protokolluar në KLSH me nr. 546/3, datë 24.08.2026 mbi njohjen e Projekt Raportit të Auditimit, për të cilin në fazën e përgatitjes së Raportit të Auditimit nuk u paraqitën observacione.

Nga grupi i auditimit të KLSH-së, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Opinioni i Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në

përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik.

Bashkia Dimal është njësi vendore institucion i pavarur, ku pas ndarjes territoriale është një bashkim mes qytetit dhe tre ish-komunave në afërsi të tij, pra në total ka 4 njësi administrative si vijon: njësia administrative Dimal (qyteti), njësitë administrative Poshnje, Kutalli dhe Cukalat. Bashkia Dimal ka një shtrirje territoriale prej 156.56 km^2 dhe si zonë gjeografike kufizohet në veri- perëndim me bashkinë Lushnjë, në veri-lindje me bashkinë Kuçovë, në jug-lindje me bashkinë Berat dhe në jug-perëndim me bashkinë e Roskovecit.
Misioni për njësinë që auditohet është: Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (*të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).*
Objektivat, burojnë nga ligji "Për vetëqeverisjen vendore".
Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni, ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.
Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.
Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.
Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:
a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.
Bashkia Dimal, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" dhe ligji nr.

68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" , i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.
Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Dimal për periudhën e aktivitetit 2025, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

Pika 1.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.
1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK:
Në zbatim të nënpikës 1.1 të programit të auditimit, u audituа dokumentacioni si më poshtë:
1.Rregullorja e brendshme e miratuar;
2.Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3.Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4.Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar;
5.Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6.Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7.Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8.Lista ose harta e proceseve të punës;
9.Raportet e Monitorimit;
10.Pyetësori i Vetëvlerësimit.
Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:
- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit; Menaxhimi i Riskut; Veprimtaritë e Kontrollit; Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Dimal, grupi i auditimit rezulton me këto konstatime:
Komponenti "Mjedisi i Kontrollit":
Në lidhje me parimin 1 "*Angazhimin për integritet dhe vlerat etike"*.
-Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili siguron vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit. Mjedisi i kontrollit përmban: a) integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; b) politikat menaxheriale dhe stilin e punës; c) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; ç) politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore; d) aftësitë profesionale të punonjësve.
Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se bashkia vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me nr.1043 prot., datë 31.03.2021 "Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të bashkisë Ura Vajgurore". Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për strukturën e institucionit. Nga auditimi rezulton, se megjithëse në strukturën organizative të

Bashkisë Dimal janë miratuar sektorë, në rregulloren e brendshme të institucionit nuk janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësit e këtyre sektorëve.
Bashkia nuk ka një Kod Etik të hartuar dhe miratuar si një dokument të veçantë, por dispozitat qe rregullojnë etikën dhe disiplinën e administratës së institucionit janë integruar në Rregulloren e institucionit.
Në bazë të pyetësorit dërguar njësive të menaxhimit, nuk ka një urdhër nga titullari i institucionit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi. Komunikimi për rregulloren e brendshme dhe dispozitat përkatëse për etikën dhe disiplinën është kryer nëpërmjet postës elektronike.
-Bashkia Dimal ka hartuar dhe krijuar Rregulloren "Për Hetimin Administrativ të Sinjalizimit dhe Konfidencialitetin me akt nr. 356 prot., datë 28.12.2017 dhe Rregulloren "Për Hetimin Administrativ dhe Kërkesën e Sinjalizuesit për Mbrojtjen nga Hakmarrja", si dhe është krijuar Njësia e Sinjalizimit të Brendshëm të përbërë nga dy punonjës me Urdhër nr. 405, datë 20.12.2016, i ndryshuar, me nr.3051, datë 13.12.2018 të Kryetarit të Bashkisë. Me shkresën nr. 210 prot., datë 13.01.2026 me lëndë **"Raport për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve për vitin 2025",** dërguar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), evidentohet se gjatë vitit 2025 nuk është regjistruar asnjë rast sinjalizimi që lidhet me veprime apo praktika korruptive.
Në lidhje me parimin nr. 2 "*Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje".*
Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua mungesa e raportimeve periodike mbi monitorimin e planit të veprimit për KB. Nga Drejtoritë dhe Sektorët nuk janë hartuar planet mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në nenin 20 të Rregullores së Brendshme është përcaktuar përgjegjësia menaxheriale e drejtuesve të të gjitha strukturave të bashkisë të cilët janë përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari, sipas shkallës hierarkike, eprorit direkt deri tek Kryetari për: "*Informacionin në kohë dhe në formën e kërkuar për rezultatet e arritura gjatë përmbushjes së përgjegjësive të tyre, për risqet dhe defektet serioze në veprimtarinë e strukturave që drejtojnë, si dhe për masat e marra e të zbatuara për riparimin e këtyre defekteve*".
Ky rregull jo gjithmonë është ndjekur dhe mungon dokumentimi i takimeve të menaxherëve me stafin e lartë menaxherial.
Në lidhje me parimin 3 *"Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë"*
Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organigramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësive funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë. Institucioni vepron mbi bazën e rregullores së brendshme të miratuar me nr. 1043 prot., datë 31.03.2021 "Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të bashkisë Ura Vajgurore", e cila përmban përshkrimin e vendeve të punës sipas funksioneve duke filluar nga specialistët deri tek Drejtorët e Drejtorive.
-Struktura organizative e bashkisë. Administrata e Bashkisë përbëhet nga funksionarët politikë (jo nëpunës civil), nëpunësit civilë dhe punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga:

Funksionet politike: Kryetari; Nënkryetarë; Sekretari i Këshillit Bashkiak. Emërimi dhe lirimi i funksionarëve politikë të bashkisë bëhet me Urdhër të Kryetarit.
Nëpunësit civilë: Shërbimi Civil në bashki organizohet dhe funksionon sipas Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke përcaktuar skemën e administrimit të këtij shërbimi. Pozicionet e shërbimit civil klasifikohen sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit. Pozicionet e shërbimit civil ndahen në këto kategori:
a. Nëpunës të nivelit të lartë drejtues: - Sekretari i Përgjithshëm.
b. Nëpunës të nivelit të mesëm drejtues: - Drejtorë Drejtorie;
c. Nëpunës të nivelit të ulët drejtues: - Përgjegjës Sektori;
d. Nëpunës të nivelit ekzekutiv: - Specialistët.
-Punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga Kodi i Punës. Përfshihen të gjithë punonjësit e tjerë.

Tabela nr.1: Struktura e Bashkisë Dimal për vitin 2025

Niveli pozicionit	Status i Nëpunësit Civil	Kodi i Punës
Kategori e lartë	1	
E mesme drejtuese	7	
E ulët drejtuese	13	
Ekzekutive	30	261
Totali	**51**	**261**

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore Dimal. Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Përgjatë vitit 2025, janë rekrutuar 18 punonjës të rinj dhe janë larguar 19 punonjës. Në dosjet e personelit ka mungesë dokumentacioni: nuk janë vendosur raportet mjeko ligjor; certifikatë personale; përshkrimet e punës etj.
Një element tjetër i rëndësishëm, i cili thekson nevojën për rritje të përgjegjshmërisë menaxheriale, është procesi i delegimit, ku u konstatua se bashkia përdor procedurat për delegimin e detyrave.
Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, por është bërë pjesë e dokumentit e PBA-ve, por këto nuk janë përfshirë as në rregulloren e brendshme.
Me Vendimin nr.03, datë 13.01.2025 "Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Bashkisë Dimal" është miratuar struktura e përbërë nga 312 punonjës, ndër të cilat 51 nëpunës civilë; 261 pozicione me kod pune.
Përgjatë vitit 2025, bashkia Dimal ka marrë vendime disiplinore 'vërejtje": për 7 punonjës, sipas rekomandimeve të KLSH.
-Bashkia Dimal nuk ka një plan strategjik për veprimtarinë vjetore ose të viteve në vijim.
Në lidhje me parimin 4 "*Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave".*
-Strukturat përgjegjëse të Bashkisë së Dimal kanë hartuar në fillim të vitit Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil duke zbatuar Ligjin nr.152/2015 "Për nëpunësin civil" neni 18, VKM nr. 108/2014 "Për plani vjetor të pranimit në shërbimin civil".
Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Prokurimeve, Shërbimeve Mbështetëse dhe Marrëdhënien me Publikun është hartuar plani i trajnimeve për vitin 2025, me shkresën me nr. 238 prot., datë 22.01.2025. Nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.
Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është vendosur në dispozicion korrespondenca për zhvillimin e një trajnimi të zhvilluar nga Drejtoria e Financës, online me temë "Faza e parë e PBA 2026-2028".

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.
Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm. Nga auditimi i kryer rezulton se bashkia ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme. Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.
Për vitin 2025, me shkresën nr. 467 prot., datë 07.02.2025, Titullari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhrin nr. 65, datë 07.02.2025 "Për ngritjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS) në Bashkinë Dimal". Në këtë urdhër, komisioni ka në përbërje 20 anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i Bashkisë.
Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik(GMS) rezultoi se:
-Bashkia Dimal ka miratuar plan pune vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik" për vitin 2025, miratuar me shkresën me nr.467/2 prot., datë 25.02.2025.
-Procesverbalet e Mbledhjeve të GMS përgjatë vitit 2025 janë të protokolluara, si dhe u konstatua firmat e anëtarëve të GMS.
-Nuk ka një urdhër për ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP).
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 20;
-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.1 "Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK" a, b, c, d, pika 2.3.1;
-VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", Kreu II. "Dosja e Personelit";
-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.1, Kapitulli IV "Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit", Kapitulli V, Anekset.

II.Komponenti"Menaxhimi i Riskut"

Në lidhje me parimin 6: *Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.*
-Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë. Nga auditimi i kryer u konstatua se, bashkia ka përgatitur Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), në të cilin evidentohen objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet që këto objektiva i përkasin. Dokumenti përfundimtar i PBA-së 2025-2027 është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 66, datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Dimal për vitin 2025". Ky dokument nuk është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë. Bashkia nuk ka hartuar plan-veprime operacionale të miratuara për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme (PBA), objektivave vjetore që të përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar. Rezulton se objektivat e miratuara nuk i komunikohen stafit të bashkisë nëpërmjet emailit apo shkresave zyrtare. Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.

Në lidhje me parimin 7: *"Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.*
Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike. Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se :
-Në Bashkinë Dimal është hartuar dhe miratuar regjistri i riskut me nr. 467/4 prot[2]., datë 27.02.2025.
-Në Bashkinë Dimal nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut.
Në lidhje me parimin 8: "*Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime*"
Duke mos patur një vlerësim të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshira detyrat dhe përgjegjësit e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe gjithëpërfshirës.
Në lidhje me parimin 9: "*Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm*".
Bashkia Dimal ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, por këto ndryshime strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:
-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 21, pika 2;
-Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 3 "Përgjegjësitë dhe detyrat e KR", pika 3.2.1 "Titullari i njësisë publike" pika 4 "Hapat për ngritjen e sistemit të MR";
-"Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.2, Kapitulli V, Anekset.

III. Komponenti: " Aktivitetet e Kontrollit"

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.
Në lidhje me parimin 10: "*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli*".
Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen

[2] Regjistri i riskut për: Drejtorinë e Financës; Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Prokurimeve, Marrëdhënien me Publikun; Drejtorinë e Shërbimeve publike; Drejtorinë e Taksave; Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Transportit; Drejtorinë e Asistencës ndaj Fermerit, Mjedisit, Shërbimit pyjor; Sektori i Arsimit; Kulturës dhe Sportit.

në raport me risqet që duhet të minimizohen. Në vijim të auditimit të kryer, u konstatua mungesa e hartave apo manualeve të proceseve të punës që sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësive. Vlen të theksojmë se përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.

Në lidhje me parimin 11: "*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë*".

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme. Bashkia nuk ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra përveç sistemeve qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS etj.) dhe nuk ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it. Ndarja e detyrave në funksionimin e sistemeve të IT- së bëhet duke hapur llogari personale për të gjithë punonjësit sipas funksionit që kanë në çdo proces. Bashkia nuk ka plan masash për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.

-Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT. Aktualisht Bashkia Dimal nuk ka një punonjës IT që të mbulojë këtë aspekt, në institucion.

Në lidhje me parimin 12: "*Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe proçedurave".*

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë. Bashkia nuk ka procedura të shkruara dhe politika të brendshme për ndarjen e përgjegjësive për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. Nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.

-Gjurma e auditimit.Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë. Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se, bashkia nuk ka ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës. Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë titullarin se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;

-Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike", pika 5.2.7 "Monitorimi dhe 21 Raportimi";

-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

IV. Komponenti: "Informimi dhe Komunikimi"

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara. Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Në lidhje me parimin 13: *Parimi 13 -Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.* Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm. Në vijim të auditimit, u konstatua se bashkia nuk i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit. Bashkia ka një sistem komunikimi dhe raportimi, si brenda dhe jashtë institucionit, por ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit. Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

Në lidhje me parimin 14: *Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.* Në faqen zyrtare të institucionit nuk pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë. Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave apo në rrugë elektronike sa herë që ka alokime fondesh.

Në lidhje me parimin 15: *Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.*

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm. Bashkia është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresore dhe evidentohet që punonjësit përdorin adresat zyrtare të e-mailit. Bashkia nuk siguron qasje publike nëpërmjet publikimit faqes së internetit të njësisë të informacionit lidhur me: Dokumentin e Buxhetit vjetor të propozuar; Buxhetin e miratuar të bashkisë; Raporte periodike të zbatimit të buxhetit; Pasqyrat vjetore financiare dhe të buxhetit; Planet vjetore të prokurimit, proceset e hapura të prokurimit, kontratat e lidhura, statistika mbi prokurimet; Raporti i auditimit të jashtëm për njësinë mbi pasqyrat financiare dhe aktivitetin e vitit paraardhës. Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Çdo sugjerim nga aktorët kryesor diskutohet për të reflektuar ndryshimet e duhura në buxhet. Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, në nenin 11" Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të Administratës së Bashkisë", neni 13 "Marrëdhëniet me Këshillin Bashkiak", neni 21"Informacioni dhe komunikimi me median", neni 9 "Marrëdhëniet me publikun".

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 23, "Informacioni dhe Komunikimi" pika 2;

-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.3, Kapitulli V, Anekset.

V. Komponenti: "Monitorimi dhe Raportimi"

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës. Nga auditimi i kryer, u konstatua se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre. Progresi lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimi i shkaqeve për dështimet e mundshme nuk monitorohet nëpërmjet raportimeve periodike. Institucioni nuk ka një plan veprimi të menaxhimit financiar dhe kontrollit të miratuar për monitorimin e MFK-së. Bashkia Dimal, monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar me shkresën nr. 749 prot., datë 26.02.2026 në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit, pranë Ministrisë së Financave. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet edhe nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm, performuar nga Njësia e Auditit të Brendshëm.

-Bashkia Dimal nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë.

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi. Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve; por nuk ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, Kreu III, neni 24, "Monitorimi" pika 1;

-"Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i miratuar me Urdhër te Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III "Komponentët e MFK" pika 3.5, Kapitulli V, Anekset.

Në lidhje me parimin 16: "*Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme*".

- Proçedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin bashkisë. Raportimet e drejtuesve të sektorëve dhe drejtorive bëhen me shkresa dhe në mënyrë verbale drejtuar eprorëve.

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili duhet hartohet cdo 4 muaj, dhe është dorëzuar brenda afateve në MFE.

-Procesi i vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm realizohet nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit të menaxherëve e strukturave, hartimit e deklaratës mbi cilësinë e kontrollit të brendshëm, si dhe me anë të njësisë të auditimit të brendshëm, e cila vepron sipas një plani vjetor dhe strategjik të miratuar nga titullari i institucionit.

-Bashkia Dimal lidhur me pyetësorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MF për vlerësimin e sistemeve për vitin 2025 me shkresën përcjellëse me nr.749 prot., datë 26.02.2026.
-Raporti i Cilësisë së Sistemeve të Kontrolli të Brendshëm paraqet në mënyrë të përmbledhur problematikat në 5 komponentët e MFK dhe është në përputhje me problematikat e evidentuara në këtë akt konstatimi. Të pesta elementet e MFK janë trajtuar në Raport, së bashku me çfarë është menduar të zgjidhet dhe organet përgjegjëse për problematikat e caktuara.
Në lidhje me parimin 17: "*Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë*".
- Sipas kontakteve me menaxhimin, nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm.
Konkluzion:- Bashkia Dimal nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm dhe nuk ka hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim, pasi nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të. Nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime, nuk ka plan për menaxhimin e riskut IT për rikuperimin e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore, nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike" dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
Znj. J. M.-Kryetar i Bashkisë Dimal;
Znj. M.B.- Drejtor i Financës dhe Buxhetit;
Znj. R.H.- Drejtor i Burimeve Njerëzore.

1.2. Mbi organizimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm

Në zbatim të Ligjit nr. 114, datë 20.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, neni 10, pika 1; VKM nr.83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik", është krijuar njësia e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100 i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm. Njësia e Auditit të Brendshëm është e organizuar në nivel sektori me 3 punonjës nga të cilët: 1 (një) përgjegjës sektori, i çertifikuar dhe 1(një) specialistë, i çertifikuar.
Tabela nr.1 -Struktura e Auditit të Brendshëm me të dhënat sipas tabelës

Nr.	Viti 2025	Funksioni	Arsimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi
1.	Q. M.	Përgjegjës i Njësisë Audituese	Finance Banke	40	9	2019
2.	V. Sh.	Specialist	Drejtësi	9	7	2023
3.	M. D.	Specialist	Financë Kontabilitet	1.6	0.7	I pa certifikuar

Burimi :*Bashkia Dimal(Sektori i Auditit të brendshëm)*

2. Planet Strategjikë dhe Vjetore të NJAB

Plani Strategjik 2025-2027 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2025 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar, me shkresën nr.2810/1 datë 17.10.2024.

***Raportimi*:** Për aktivitetin e veprimtarisë së Strukturës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025 është raportuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 81/1 prot., datë 13.02.2026.

***Karta e AB*:** Karta e auditimit të brendshëm është përgatitur dhe miratuar nga Titullari i Bashkisë Dimal me urdhrin nr.508 prot., datë 21.02.2019. Sektori i Auditit të Brendshëm ka kod etike pa nr.prot. dhe datë.

Plani vjetor i punës së Auditit të Brendshëm të miratuar nga Titullari i Bashkisë Dimal, për vitin 2025.

Në Planin Vjetor të punës së Auditit të Brendshëm, të miratuar nga Titullari i Bashkisë, me nr. 3018/1 prot., janë planifikuar 5 auditime për vitin 2025.

1. Drejtoritë dhe sektorë (Zbatimi i rekomandimeve të auditimeve të brendshme gjatë vitit të mëparshëm);
2. Drejtoria e Ekonomisë, Financës dhe Menaxhimit të Aseteve;
3. Drejtoria e Tatim-Taksave dhe menaxhimit të borxhit;
4. Drejtoria e Shërbimeve publike;
5. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Prokurimeve dhe Shërbimeve Mbështetëse, Marrëdhënie me Publikun, Ndihmës ekonomike, PAK, dhe Kujdesi Social.

Tabela nr.2 Subjektet e planifikuara për vitin 2025

Nr.	Planifikuar	Realizuar	Niveli i Riskut
1.	Drejtoritë dhe sektorë (Zbatimi i rekomandimeve të Auditimeve të brendshëm gjatë vitit të mëparshëm)	Po	I lartë
2.	Drejtoria e Tatim Taksave dhe menaxhimit te borxhit	Po	I lartë
3.	Drejtoria e Shërbimeve publike	Po	I lartë
4.	Drejtoria e Burimeve njerëzore, prokurimeve dhe shërbimeve mbështetëse, marrëdhënie me publikun, ndihmës ekonomike, PAK, dhe Kujdesi Social	Po	I lartë
5.	Drejtori, sektor, inspektoriate, qendra administrative dhe zyra të bashkisë me emra konkret për secilin punonjës. Performanca e burimeve njerëzore në administratën e Bashkisë Dimal " Auditim Performance"	Po	I mesëm
6.	Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) pranë Bashkisë Dimal	Po	I lartë

Burimi: Bashkia Dimal

Tabela nr.3 Auditimet e planifikuara dhe të realizuara.

Nr.	Periudha	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT								
		Auditime te planifikuara	Auditime te realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit						
				Përputshmëri	Financiar	Kombinuar	Performance	Tematik	Teknologjisë se Informacionit	Zbatim Rekomandime
1	Viti 2025	5	7	5			1	1		

Burimi: Bashkia Dimal

Duke iu referuar tabelës më sipër rezulton se janë planifikuar 5 (pesë) auditime dhe janë realizuar 7 (shtatë) auditime. Me kërkesë të Titullarit gjatë vitit 2025, sektori i auditimit të brendshëm është angazhuar edhe në 2 subjekte të tjera.

Tabela nr.4 Rekomandimet e dhëna

Nr	Periudha	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pa Zbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pa Zbatuar
1	Viti 2025	40	6	30	4	0			
Totali									

Burimi: Bashkia Dimal

-Karta e Auditimit të Brendshëm është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhërin nr.100, datë 25.10.2016" me nr. 508 prot., datë 21.02.2019;

-Plani strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2025-2027, dhe është hartuar në përputhje me standardet e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe aneksin me modelin përkatës në fundin e kapitullit III me nr. 2810 /1 , datë 17.10.2024 .

-Bashkia Dimal nuk ka parashikuar në strukturën e saj, Komitetin e Auditimit të Brendshëm.

- Për periudhën e auditimit te vitit ushtrimor 2025 janë dhënë në total 40 rekomandime nga të cilat janë pranuar 40 rekomandime.

-Në dosjet koherente të auditimit mungojnë dokumentacioni si: Buxheti dhe afati kohor për angazhimet e auditimit; takimi fillestar me organizatën etj.

- Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2025, nuk është hartuar plotësisht në përputhje me Urdhërin nr., 4, datë 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

-Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore në kundërshtim me nenin 19, pika 1 e "Normave Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë".

-Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit, duke rënë në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kreu 6, paragrafin 6.3.

-Në dosjet e auditimit të realizuar nga Njësia e Auditimit nuk është dokumentuar plani i veprimit, i cili duhet të realizohet nga subjekti i audituar në vazhdën e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit. Edhe pse vërtetohet se grupi i auditimit të brendshëm ka lënë për detyrë hartimin e një plani veprimi për zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi fizik i disa prej dosjeve të përzgjedhura u konstatua mungesa e planeve të veprimit nga ana e subjekteve të audituara.

Konkluzion: Bashkia Dimal nuk ka parashikuar në strukturën e saj, Komitetin e Auditimit të Brendshëm. Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2025, nuk është hartuar plotësisht në përputhje me urdhërin nr., 4, datë 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore. Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit. Në dosjet e auditimit të realizuar nga Njësia e Auditimit nuk është dokumentuar plani i veprimit, i cili duhet të realizohet nga subjekti i audituar në vazhdën e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit. Edhe pse vërtetohet se grupi i auditimit të brendshëm ka lënë për detyrë hartimin e një plani veprimi për zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi fizik i disa prej dosjeve të përzgjedhura u konstatua mungesa e planeve të veprimit nga ana e subjekteve të audituara. Në dosjet e auditimit nuk janë konstatuar shkresa rikujtuese

nga ana e përgjegjësit të njësisë së auditimit drejtuar njësive të menaxhimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 13, Urdhëri nr., 4, datë 10.10.2020 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Normave Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19, pika 1, Manuali i Auditimit të Brendshëm, paragrafi 4.1.12, Kreu 6, paragrafin 6.3, Kreun IV, paragrafi 4.1.13.1 .
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
Znj.J.M.-Kryetare e Bashkisë Dimal;
Z.Q. M.- në cilësinë e Përgjegjësit të Njësisë së Auditit të Brendshëm;
Znj.V. Sh.-në cilësinë e specialistes në Njësinë e Auditit të Brendshëm
Z.M.D.-në cilësinë e specialistit në Njësinë e Auditit të Brendshëm.

Pika 2.1 e programit. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
Për vitin 2025, sipas Strukturës së miratuar me Vendimin e Kryetarit të bashkisë nr. 03, datë 13.01.2025, "*Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Bashkisë Dimal*", ka funksionuar Drejtoria e Ekonomisë Financës dhe Menaxhimit të Aseteve me 9 punonjës, nga të cilët 1 (një) Drejtor Drejtorie, 1(një) Përgjegjës Sektori, 5(pesë) Specialist, 1(një) inspektorë dhe 1 (një) Magazinier llogaritarë.

Programimi i PBA për vitet 2025-2027.
Nga auditimi i procedurave për përgatitjen **PBA 2025-2027**, rezultoi se miratimi i treguesve ekonomik financiarë dhe tavanet përgatitore janë miratuar me VKB nr.25, datë 30.04.2024. "Për miratimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë të Bashkisë së Dimal dhe tavaneve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2025-2027". Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 65, datë 07.02.2025 është miratuar "Ngritja e grupit për menaxhim strategjik" dhe ekipeve të menaxhimit të programeve, për vazhdimin e procesit të përgatitjes së PBA 2025-2027, i cili është i detajuar sipas 15 programeve buxhetore, njësive shpenzuese dhe klasifikimit ekonomik, për vitin 2025 paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2025		Viti 2026		Viti 2027	
		000/lekë	% ndaj totalit	000/lekë	% ndaj totalit	000/lekë	% ndaj totalit
1	Planifikimi Menaxhimi Administrimi	119,274		121,589		127,748	
2	Shërbimi i Policisë Vendore	9,579		9,565		9,858	
3	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	22,993		23,291		23,519	
4	Menaxhimi I ujitjes dhe kullimit	35,285		35,773		36,122	
5	Menaxhimi I pyjeve dhe kullotave	1,039		1,050		1,060	
6	Rrjeti rrugor rural	153,377		157,830		167,197	
7	Menaxhimi I mbetjeve	979		998		1,007	
8	Strehimi lokal dhe urbanistika	10,815		11,025		11,130	
9	Shërbimet publike vendore	117,677		119,962		121,104	
10	Sport dhe Argëtim	3,090		3,150		3,180	
11	Trashegi Kulturore	17,096		17,428		17,594	
12	Arsimi baze përfshirë sistemin e arsimit parashkollor	70,426		71,279		71,984	
13	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	1,919		1,937		1,956	
14	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	23,275		23,625		23,850	
15	Fondi Rezerve	7,491		7,575		7,617	
	TOTAL	**601,706**		**613,852**		**627,543**	

Burimi: Drejtoria e Buxhetit.

Sipas PBA tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë**:**

Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2025-2027.

Nr.	Të ardhurat	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
1	Të ardhura tatimore	172,975	172,975	172,975
2	Të ardhura jo tatimore	84,906	84,906	84,906
I	**Total të ardhura**	**257,881**	**257,881**	**257,881**
3	Transferta e pakusht. e përgjithshme	193,978	205,495	218,196
4	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	124,847	125,836	126,835
II	**Total transferta**	**318,825**	**331,331**	**345,031**
III	**Të ardhura të mbartura**	**25,000**	**24,640**	**24,631**
	Totali	**601,706**	**613,852**	**627,543**

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton se të ardhurat sipas PBA për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 601,706 mijë lekë, për vitin 2026 në vlerën 613,852 mijë lekë ose me rritje krahasuar me vitin paraardhës në vlerën 12,146 mijë lekë dhe për vitin 2027 në vlerën 627,543 mijë lekë ose krahasuar me vitin 2026 me rritje në vlerën 13,691 mijë lekë.

Programimi i shpenzimeve sipas llogarive për periudhën viti 2025-2027, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

000/lekë

Nr.	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2025		Viti 2026		Viti 2027	
		000/lekë	%	000/lekë	%	000/lekë	%
1	Paga (600+601)	243,008	40%	247,048	40.2%	249,433	39.7%
2	Shp. Operative (602+603+604+605+606+609)	168,050	27.9%	170,935	27.8%1	172,515	27.5%
3	Investime (230,231)	190,648	32.1%	195,869	32%	205,595	32.8%
	Totali	**601,706**	**100%**	**613,852**	**100%**	**627,543**	**100%**

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton se tendenca e shpenzimeve sipas PBA për vitin 2025 janë planifikuar në vlerën 601,706 mijë lekë, për vitin 2026 në vlerën 613,852 mijë lekë ose me rritje krahasuar me vitin paraardhës në vlerën 12,146 mijë lekë dhe për vitin 2027 në vlerën 627,543 mijë lekë ose krahasuar me vitin 2026 me rritje në vlerën 13,691 mijë lekë.

Mbi dokumentacionin mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Buxheti fillestar i vitit 2025, është miratuar me **VKB nr. 66, datë 27.12.2024 ,** bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetë Qeverisjes Vendore, ligjit nr. 115/2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", Udhëzimi Plotësues i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 24.01.2025, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresë nr. 105, datë 13.01.2025, si më poshtë:

Nr	Vendimi K.B		Struktura e të ardhurave	Të ardhura Plan (në 000/lekë)	Struktura e shpenzimeve	Shpenzimet (në 000/lekë)
	Nr.	Datë				
	66	24.12.2024				
1			Të ardhura tatimore	163,616	Paga (600)	253,684
2			Të ardhura jo tatimore	102,056	Sig. Shoq. (601)	42,519
3			Transferta e pakusht. përgjithshme	246,110	Shp. Operative (602)	129,512
4			Transferta e pakushtëzuar sektoriale	123,060	Shpenzime (603,604,606,609)	29,500
5			Të ardhura të mbartura	27,000	Investime (230,231)	206,627
			Total	**661,842**	**Total**	**661,842**

Burimi i financimit të buxheti fillestar për vitin 2025, janë planifikuar për tu përballuar nga të ardhurat e veta të vitit në shumën 265,672 mijë lekë ose 40 % e totalit, nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme në shumën 246,110 mijë lekë ose 37 % e totalit, nga transferta e pakushtëzuar sektoriale në shumën 123,060 mijë lekë ose 19% e totali, të ardhurat e trashëguara në shumën 27,000 mijë lekë ose 4 % e totalit.

Për sa i përket shpenzimeve rezulton se për vitin 2025 shpenzimet për paga e sigurime zënë 45 % ose në vlerën 296,203 mijë lekë, shpenzime operative zënë 20 % ose për vlerën 129,512 mijë lekë, shpenzime për (603,604,606,609) zënë 4% ose në vlerën 29,500 mijë lekë dhe shpenzime për investime zënë 31% ose në vlerën 206,627 mijë lekë.

Për vitin 2025, buxheti ka pësuar ndryshime në rritje për vlerën 330,110 **mijë lekë**, kjo e analizuar si më poshtë:

Art	2025				
	Plan Fillestar	**Ndryshimet +/-**	**Plani fund viti**	**Realizimi**	**Realizimi %**
600	253,684	+2,405	256,089	251,749	98.30%
601	42,519	-1,459	41,060	40,383	98.35%
602	129,512	+29,416	158,928	123,752	77.86%
604-609	29,500	+148,687	178,187	162,849	91.39%
230-231	206,627	+151,061	357,688	281,379	78.67%
TOTAL	***661842***	***330,110***	***991,952***	**860,112**	**86.70%**

Ndryshimet e buxhetit në rritje për vlerën 330,110 mijë lekë, vijnë nga të ardhurat e trashëguara për grande të ardhura për gjatë viti si dhe nga transfertat nga grand i kushtëzuar për ndihma e paaftësi dhe shpenzime për investime nga Ministritë e linjës. Nga të dhënat e pasqyrës sa më sipër rezulton se rritje më të lartë kanë plani i shpenzimeve për investime në vlerën 151,061 mijë lekë kryesisht nga të ardhurat e veta në vlerën 11,136 mijë lekë nga grandi pakushtëzuar në vlerën 65,480 mijë lekë dhe grand i kushtëzuar në vlerën 67,885 mijë lekë.

2.3 Mbi dokumentacionin mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me shkresën nr. 794 prot., datë 02.03.2026 "Mbi raportin e monitorimit për 12/mujorin e vitit 2025" është dërguar në Ministrinë e Financave tabela mbi treguesit fiskal të konsoliduar të Bashkisë dhe realizimi faktik i buxhetit sipas planit të rishikuar si më poshtë:

Në lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti vjetor (Plan rishikuar) viti 2025	Periudha e raportimit (Fakt progresiv) 31.12.2025
I	**Të ardhurat gjithsej**	**265,672**	**214,881**
1	Taksa e veta vendore	126,411	63,373
2	Të ardhura jo tatimore	102056	108,397
3	Taksa të ndara	37,205	43,111
II	**Shpenzimet të buxhetit vendor**	**991,952**	**860,112**
1	**Shpenzime korrente**	**634,264**	**578,733**
a	Paga dhe fond i veçantë	256,089	251,749
b	Kontribut për sigurime shoqërore	41,060	40,383
c	Shpenzime operative	158,928	123752
d	Të tjera korente	178,187	162,849
2	**Shpenzime kapitale investime**	**357,688**	**281,379**
3	**Burimet e financimit**	**991,952**	**860,112**
a	Të ardhura të veta vendore	281,487	204,975
b	Transferta e pakushtëzuar	351,464	294,784
c	Transferta specifike	123,060	123,060
d	Transferte e kushtezuar	235,940	234,854
	Te ardhura jashte limitit kap/6	2,486	2,439

Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2025, janë dërguar MFE me shkresat nr.1564 Prot, datë 27,05.2025 "Mbi raportin e monitorimit për 4/mujorin e parë", nr. 1564/1 Prot, datë 24.09.2025 "Mbi raportin e monitorimit për 8/mujorin" dhe shkresa nr. 794 Prot, datë 02.03.2026 "Mbi raportin e monitorimit për 12/mujorin e vitit 2025".

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit në total për Bashkinë për periudhën **viti 2025,** referuar akt rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Ne mijë lekë

Nr	EMERTIMI Sipas Artikujve Te shpenzimeve	Viti 2025			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% / planit përfundimtar
	Bashkia	1	2	3	4
1	Llog.600 - Paga	253,684	256,089	251,749	98.30%
2	Llog 601 -	42,519	41,060	40,383	98,35%
3	Llog 602-	129,512	158,928	123,752	77,86%
4	Llogaria 604+606	29,500	178,187	162,849	91,39%
5	Llog 231	206,627	357,688	281,379	78,67%
	Shuma	**661,842**	**991,952**	**860,112**	**86,70%**

Me vendimin nr. 1, datë 15.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë "Për miratimin e strukturës të administratës së Bashkisë dhe të njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Kuçovë për vitin 2025" ka miratuar strukturën organike, kategoritë/klasat e pagave të administratës së Bashkisë dhe Njësive shpenzuese në varësi të saj për vitin 2025, për numrin e përgjithshëm të punonjësve gjithsej 312 punonjës

Realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2025, plani me rritjet gjatë vitit sipas situacionit në vlerën 991,952 mijë lekë është realizuar në fakt në vlerën 860,112 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 131,840 mijë lekë ose 13% e totalit të shpenzimeve të planifikuara.

Pagat plani në rritje për vlerën 256,089 mijë lekë është realizuar në vlerën 251,749 mijë lekë ose 98 %, Sigurimet shoqërore plani në rritje për vlerën 41,060 mijë lekë është realizuar 40,383 mijë lekë ose 98 %, shpenzimet operative plani në rritje për vlerën 158,928 mijë lekë është realizuar në vlerën 123,752 mijë lekë ose 78 %, ndihma e paaftësi janë planifikuar për vlerën 178,187 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 162,849 mijë lekë ose 91 %, shpenzimet për investime plani në rritje për vlerën 357,688 mijë lekë është realizuar në vlerën 281,379 mijë lekë ose 79 %.

Realizimi i shpenzimeve të planifikuara dhe realizuara **nga granti i pakushtëzuar** paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Nr	EMERTIMI Sipas Artikujve Te shpenzimeve	Viti 2025			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% / planit përfundimtar
	Bashkia		2	3	4
1	Llog.600 - Paga	80,049	75,549	75,625	100%
2	Llog 601 -	28,739	26,337	26,005	98.73%
3	Llog 602-	44,648	81,802	52,948	64.72%
4	Llog 231	106,255	171,735	144,827	84.33%
	Shuma	**259,691**	**355,423**	**299,406**	**84.23%**

Realizimi i shpenzimeve të mbuluara nga grand i pakushtëzuar sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2025, plani me rritjet gjatë vitit sipas situacionit në vlerën 355,423 mijë lekë është realizuar në fakt në vlerën 299,406 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 56,017 mijë lekë ose 16% e totalit të shpenzimeve të planifikuara.

Me mosrealizim paraqiten shpenzimet operative në vlerën 28,824 mijë lekë *(planifikuar 81,802 mijë lekë, realizuar 52,948 mijë lekë ose 65%)* shpenzimet për investime në vlerën 26,908 mijë lekë *(planifikuar 171,735 mijë lekë, realizuar 124,827 mijë lekë ose 84%)*.

Realizimi i shpenzimeve të planifikuara dhe realizuara **nga të ardhurat e veta** paraqitet si më poshtë:

Nr	EMERTIMI Sipas Artikujve Te shpenzimeve	Viti 2025			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% / planit përfundimtar
	Bashkia	1	2	3	4
1	Llog.600 - Paga	92,578	92,578	91,878	99.20%
2	Llog 601 -	0	0	0	0
3	Llog 602-	59,936	61,255	43,352	70.77%
4	Llogaria 604	10,000	4,600	0	0
5	Llogaria 606+609	5,800	13,900	4,357	65%
6	Llog 231	98,018	109,154	67,727	62%
	Shuma	**280,672**	**281,487**	**204,975**	**73%**

Realizimi i shpenzimeve të mbuluara nga të ardhurat e veta sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2025, plani me rritjet gjatë vitit sipas situacionit në vlerën 281,487 mijë lekë është realizuar në fakt në vlerën 204,975 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 76,512 mijë lekë ose 27% e totalit të shpenzimeve të planifikuara.
Me mosrealizim paraqiten shpenzimet operative në vlerën 17,903 mijë lekë *(planifikuar 61,255 mijë lekë, realizuar 43,352 mijë lekë ose 71%)* shpenzimet për investime në vlerën 41,427 mijë lekë *(planifikuar 109,154 mijë lekë, realizuar 67,727 mijë lekë ose 62%)*, kjo më e ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit në tërësi nga të ardhurat e veta, i cili është realizuar në masën 73%.

Realizimi i shpenzimeve të planifikuara dhe realizuara **nga transferta specifike,** paraqitet si më poshtë:

Nr	EMERTIMI Sipas Artikujve Te shpenzimeve	Viti 2025			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% / planit perfundimtar
	Bashkia	1	2	3	4
1	Llog.600 - Paga	81,057	82,638	78,954	97.4%
2	Llog 601 -	13,780	13,780	13,641	98.9%
3	Llog 602-	24,928	24,928	24,928	100%
4	Llogaria 606	800	800	0	0%
	Llog 231	914	914	914	100%
	Shuma	**121,479**	**123,060**	**118,437**	**96.24%**

Realizimi i shpenzimeve të mbuluara nga transferta specifike të kushtëzuara, sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2025, plani me rritjet gjatë vitit sipas situacionit në vlerën 123,060 mijë lekë është realizuar në fakt në vlerën 118,437 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 4,623 mijë lekë ose 9% e totalit të shpenzimeve të planifikuara.

Realizimi i shpenzimeve të planifikuara dhe realizuara **nga grand i kushtëzuar për transferta për ndihmë ekonomike e paaftësi etj. viti 2025** paraqitet si më poshtë:

Nr	EMERTIMI Sipas Artikujve Te shpenzimeve	Viti 2025			
		Plani fillestar	Plani sipas situacionit	Fakti	% / planit perfundimtar
	Bashkia	1	2	3	4
1	Llog.600 - Paga	0	5,324	5,291	99.38%
2	Llog 601 -	0	942	737	78.2%
3	Llog 602-	0	2,943	2,524	85.76%

4	Llogaria 606	0	158,846	158,492	99.77%
	Llog 231	0	67,885	67,810	99.88%
	Shuma	**0**	**235,940**	**234,854**	**99.53%**

Realizimi i shpenzimeve të mbuluara nga grand i kushtëzuar, sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2025, plani me rritjet gjatë vitit sipas situacionit në vlerën 235,940 mijë lekë është realizuar në fakt në vlerën 234,854 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 1,086 mijë lekë, ose 0.5 % e totalit të shpenzimeve të planifikuara.

Përdorim i te ardhurave jashtë limitit për vitin 2025

Nr	**EMERTIMI**	**Viti 2025**			
	Sipas Artikujve				
	Te shpenzimeve				
		Plani fillestar	**Plani sipas situacionit**	**Fakti**	**% / planit perfundimtar**
	Bashkia	1	2	3	4
2	Llog 602-	0	2,486	2,439	98.10%
	Shuma		**2,486**	**2,439**	**98.10%**

Konkluzion: Nga auditimi ka rezultuar se realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakordimit me degën e thesarit për periudhën objekt auditimi nga 991,952 mijë lekë të planifikuara është realizuar në vlerën 860,112 mijë lekë ose në masën 87 %, me mosrealizim në vlerën 131,840 mijë lekë, konstatohet se ka diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore për shpenzime operative në vlerën 35,175 mijë lekë *(planifikuar 158,927 mijë lekë janë realizuar 123,752 mijë lekë ose 78%)* dhe shpenzimet për investime në vlerën 76,309 mijë lekë *(planifikuar 357,688 mijë lekë janë realizuar 281,379 mijë lekë ose 79%)* kjo si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, realizimi i procedurave të prokurimit në fund të vitit lidhja e kontratave me vonesë dhe shpenzimeve operative të planifikuara, me ndikimin që ka në funksionimin dhe ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, rezulton se realizimi i tyre është më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit në tërësi, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*", i ndryshuar neni 5, germa **"a"** *ku përcaktohet.....në hartimin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohen në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të viteve të mëparshme.*

2.4. *Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve etj.*

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me shkresën nr. 794 Prot, datë 02.03.2026 "Mbi raportin e monitorimit për 12/mujorin e vitit 2025" është dërguar në Ministrinë e Financave tabela për detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara, vendime gjygjësore etj. si më poshtë:

N.R	**Emërtimi**	**Stoku në vlerë**	**Totaliishpenzimevetëmiratuarapër NJVQV-në**	**Stoku/Shpenzimevetotaletëmiratuaratë NJQV-së**
I	**Borxhe (a+b)**			
a	**Hua sfatgjatë**			
a,1	Marveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft)			

a,2	Tituj të emërtuar			
a.3	Garanci për të tretë			
b	**Hua afatshkurtër**			
b,1	Marveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft)			
b,2	Tituj të emërtuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	**Detyrime të prapambetura**			**19.41%**
Llog	**Emertimi**			
4864100	**Vendime gjygjsore**	11,865,021		
4864200	Det prap. Sherbime	11,340,429		
4864300	Det prap. Mirmbajtje	5,428,929		
4864400	Det Prap. Investime	62,746,764		
486,4600	**Mallra**	**29,984,611**		
4864601	Det.Prap. Sig. Shoqërore	0		
4864602	Det.Prap. Sig. Shendetsore	0		
486,4603	Det. Prapa. Ardhura personale	0		
4864604	Det. Prapa. Tatime të tjera.	**0**		
4864903	Transferta te individë	0		
III	**Totali (I+II)**	**121,365,754**	**625,257,291**	**19.41%**

Nga të dhënat e tabelës nuk janë raportuar detyrimet për fatura të palikujduara në vlerën 6,293,141 lekë, pasi fondet janë transferta të kushtëzuara të Ministrisë së linjës për objektin "Rikonstruksion i kanalit të Goriçani"

Rezulton se totali i detyrimeve të pa likuiduara të financuara nga fondet e Bashkisë në vlerën 121,365,754 lekë në raport me shpenzimet e vitit që janë 625,257,291 lekë zënë 19,41%.

Nga auditimi ka rezultuar se detyrimet për vendime gjyqësore në fillim të vitit janë për vlerën 9,140,021 lekë të cilat gjatë vitit janë shtuar për vlerën 6,000,000 lekë dhe janë likuiduar për vlerën 3,275,000 lekë dhe në fund të periudhës janë për vlerën 11,865,021 lekë, të analizuara në pasqyrën Aneks nr. 1, bashkëlidhur.

Nga auditimi ka rezultuar se detyrime për fatura të palikujduara për shërbime në fund të vitit janë për vlerën 11,340,429 lekë, nga Drejtoria e Financës nuk janë likuiduar sipas rradhës së pagesës detyrimet për faturat e periudhës viti 2022 për 4 fatura të vitit 2022, në vlerën 10,983,629 lekë të analizuara paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 2, bashkëlidhur.

Nga auditimi ka rezultuar se detyrime për fatura të palikujduara për mallra dhe mirëmbajtje në fund të vitit janë për vlerën 35,413,540 lekë konstatohet se nuk është ndjekur rradha e pagesës për 12 fatura të periudhës në vlerën 13,286,815 lekë, të analizuara paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 3, bashkëlidhur.

Nga auditimi ka rezultuar se fatura të palikujduara për investime në fund të vitit janë për vlerën 69,039,905 lekë konstatohet se nuk është ndjekur rradha e pagesës për 16 fatura të periudhës viti 2020-2024, në vlerën 52,010,161 lekë, të analizuara paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 4, bashkëlidhur.

Konkluzion: Nga auditimi ka rezultuar se detyrime për fatura të pa likuiduara dhe vendime gjykate të raportuara ne MFE në fund të vitit me shkresën nr. 794 Prot., datë 02.03.2026 "Mbi raportin e monitorimit për 12/mujorin e vitit 2025", janë për vlerën 121,365,754 lekë *(shpenzime mirëmbajtje, shërbime e mallra në vlerën 46,397,169 lekë, shpenzime kapitale në vlerën 62,746,764 lekë dhe shpenzime gjyqësore në vlerën 11,865,021 lekë)* në raport me shpenzimet e kryera zënë 19.41% të tyre. Nga verifikimi i faturave të palikuiduara u konstatua se nuk është ndjekur radha e pagesës për 32 fatura në vlerën 76,280,605 lekë. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 40,42. Udhëzimin i MFE nr. 9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5,

datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Kreu "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", pikat 82-91.
Për sa trajtuar më lart mbahet akt konstatimi me znj. M.B. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë Financës dhe Menaxhimit të Aseteve, për periudhën objekt auditimi.

-Mbi parashikimin dhe realizmin e të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të paarkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor 2025

Për vitin 2025, sipas Strukturës së miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 03, datë 13.01.2025, "*Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Bashkisë Dimal*", ka funksionuar Drejtoria e Taksave dhe Sektori Borxhit me 12 punonjës, nga të cilët 1 (një) Drejtor Drejtorie, 2(dy) Përgjegjës Sektori, 1(një) Specialist dhe 8(tetë) inspektorë.
Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është bërë duke mbajtur në konsideratë numrin e bizneseve dhe familjeve, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli i Bashkisë.
Administrimi i taksave vendore bëhet me program, ku janë të pasqyruara regjistrat e biznesit të madh dhe të vogël ne kodin përkatës dhe me bazën e të të dhënave përkatëse, me ngarkesat për detyrimet e taksave dhe tarifat vendore, pagesat dhe gjendjet debitore,si dhe dosjet për secilin takaspagues me njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë**.** Sipas të dhënave të Drejtorisë së Taksave dhe Sektori Borxhit, gjendja e subjekteve tatimpagues në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Dimal paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Lloji Biznesit	Viti 2025			
	Gjendja fillim	Biznese të reja	Biznese të mbyllur	Gjendja në fund
B. Vogël	589	34	31	592
B. Madh	173	13	9	177
Ambulant	3	0	0	3
Institucione +OJF	16	0	0	16
Familjare	4569	0	0	4569
Gjithsej	**5 350**	**47**	**40**	**5357**

Për periudhën objekt auditimi planifikimi i taksave dhe tarifave vendore është kryer në zbatim të VKB nr. 59, datë 27.11.2024 "*Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në bashkinë e Dimal, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2025*", për 788 biznese dhe 5357 familje.
Në mënyrë analitike planifikimi dhe realizmi i të ardhurat për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025 paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 1, bashkëlidhur.

Nga të dhënat rezulton se, për vitin 2025, të ardhurat gjithsej, nga 265,672 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 214,881 mijë lekë ose 11 %, **me një mosrealizim në vlerën 50,791 mijë lekë, ku vlerën më të madhe të mosrealizimit e zënë debitorët të cilët nga 76,350 mijë lekë të planifikuar janë realizuar për vlerën 44,083 mijë lekë ose më pak për vlerën 32,267 mijë lekë.**
Treguesit e tjerë për taksa e tatime janë realizuar mbi 85% të planit.
Nga të dhënat e Drejtoria e Taksave dhe Sektori Borxhit, për vitin 2025 të ardhurat për taksat dhe tarifat vendore të cilat mblidhen me agjent tatimorë paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Të ardhurat nga taksat e ndara	**Plani**	**Fakti**
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	47,986	65,762
Te ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	4,577,096	16,913,848
Taksa e mjeteve të përdorura të transportit	21,365,776	24,774,460
Tarifat/ gjelbërim, ndriçim, pastrim, arsimi, ndërtesa	12,076,684	23,576,199
Taksa e rentës minerare	5,525,976	1,423,425

Totali	**43,593,518**	**66,753,694**

Përsa më sipër planifikimi i të ardhurave nga taksat e ndara bëhet sipas realizimit të një viti më përpara, likuidimet janë kryer pa pasur të dhëna mbi bazën e të cilave bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave. Në totalin e të ardhurave të realizuara në vlerën 214,881,148 lekë, taksat të cilat mblidhen me agjent tatimorë janë realizuar në vlerën 66,753,694 lekë ose 31% e realizimit.

Gjendja e debitorëve me datë 31.12.2025.

Nga të dhënat e vëna në dizpozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Sektori Borxhit, sipas listave që disponon mbi debitorët për taksa e tarifa vendore për biznesin, familjarë për taksa e tarifa vendore, pikat e tregtimit të karburanteve, lejet e legalizimeve për ndërtimet pa leje dhe debitorë për toka me qira rezulton se në fillim të vitit 2015 kanë qenë për vlerën 309,907,303 lekë për gjatë vitit janë shtuar debitorë në shumën 61,894,920 lekë dhe pakësuar(arkëtuar) në vlerën 44,549,921 lekë dhe gjendja në fund me datë 31.12.2025 janë për vlerën 327,252,302 lekë, të cilët nga Drejtoria e Taksave dhe Sektori Borxhit janë dërguar me shkresë nr. 970 prot., datë 17.03.2026 për kontabilizimin e tyre nga Drejtoria e Financës.

Dinamika e debitorëve për shtesa e paksime për periudhën objekt auditimi paraqiten si më poshtë:

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dizpozicion u konstatua se debitorë të biznesit të madh e të vogël dhe familjarë në fillim të vitit 2025 kanë qenë për vlerën 256,668,549 lekë për gjatë vitit janë shtuar debitorë në shumën 51,920,862 lekë dhe pakësuar(arkëtuar) në vlerën 42,836,941 lekë dhe gjendja në fund debitorë progresiv me datë 31.12.2025 janë për vlerën 265,752,470 lekë *(për 117 subjekte në shumën 40,247,940 lekë dhe 4595 familjarë në vlerën 225,504,530 lekë)* në mënyrë të përmbledhur pasqyra e debitorëve si më poshtë:

EMËRTIM	**Gjendja 31.12.2024**	**Shtesa për Vitin 2025**	**Paksime viti 2025**	**Gjendja progresiv 31.12.2025**	**Numëri Subjekte Familjarë**
Debitorë ne total	**256,668,549**	**51,920,862**	**42,836,941**	**265,752,470**	**4 712**
Biznesi i madh e vogël	38,965,469	5,097,008	3,814,537	40,247,940	117
Familje për taksa tarifa	217,703,080	46,823,854	39,022,404	225,504,530	4 595

Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve Drejtoria e Taksave dhe Sektori Borxhit edhe pse ka zbatuar përcaktimet në Kreun XI "*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, konstatohet se në fund të periudhës janë debitorë progresiv 117 subjekte për vlerën 40,247,940 lekë *(nga kjo debitorë të vitit 2025 janë shtuar për vlerën 5,097,008 lekë)* të dhënat në pasqyrën Aneks nr. 2, bashkëlidhur dhe debitorë progresiv familjarë janë 4595 familje për vlerën 225,504,530 lekë *(nga kjo debitorë të vitit 2025 janë shtuar për vlerën 46,823,854 lekë),* pra debitorët gjithsej në fund të periudhës të kontabilizuar janë për vlerën 265,752,470 lekë, **nga e cila vlera prej 51,920,862 lekë** janë debitorë të vitit 2025 **të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dizpozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, Drejtoria e Taksave dhe Sektori Borxhit edhe pse ka zbatuar përcaktimet ligjore të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë,* pika 3/c, rezulton se në fillim të vitit 2025 debitorë kanë qenë për vlerën 5,516,143 lekë për gjatë vitit 2025 nuk kanë likuiduar detyrimet në shumën 3,980,449 lekë dhe janë arkëtuar detyrime ë vlerën 3,234,277 lekë, pra debitorët progresiv gjithsej në fund të periudhës të kontabilizuar janë për **219 objekte**

të personave në vlerën 6,262,316 lekë, **nga e cila vlera prej 3,980,449 lekë** shtuar gjatë vitit 2025 **janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë,** të dhënat në pasqyrën Aneks nr.3, bashkëlidhur

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dizpozicion në lidhje me pagesën e detyrimeve për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, Drejtoria e Taksave dhe Sektori Borxhit edhe pse ka zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 35, të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar, rezultoi nuk kanë likuiduar detyrimet subjekti "D.O." ShPK në vlerën 800,000 lekë, subjekti "A." ShPK në vlerën 1,000,000 lekë dhe subjekti "2. Sh." Poshnje në vlerën 400,00 lekë, gjithsej **në vlerën 2,200,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë.**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dizpozicion në lidhje me pagesën e detyrimeve për qira të tokave bujqësore rezultoi se Drejtoria e Taksave dhe Sektori Borxhit edhe pse ka zbatuar përcaktimet e kushteve të kontratave të lidhura për dhënien e tokave me qira dhe mënyrën e likujdimit të tyre rezulton se në fillim të vitit 2025 debitorë kanë qenë për vlerën 14,439,742 lekë për gjatë vitit 2025 nuk kanë likuiduar detyrimet në shumën 2,511,742 lekë dhe janë arkëtuar detyrime ë vlerën 566,568 lekë, pra debitorët për dhënien e tokave me qira progresiv në fund të periudhës të kontabilizuar janë për **39 kontrata qiraje** në vlerën 16,384,916 lekë, **nga e cila vlera prej 2,511,742 lekë** shtuar gjatë vitit 2025 **janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.**

Për sa trajtuar më lart mbahet akt konstatimi me z. I. Sh. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Sektorit të Borxhit, për periudhën objekt auditimi.

Pika. 3 e programit. Mbi auditimin e llogarive vjetore, për vitin 2025.

Për të arritur në opinionin, nëse pasqyrat financiare për vitin 2025, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktive neto dhe fluksit të parasë bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Drejtoria e Ekonomisë Financës dhe Menaxhimit të Aseteve ka përpunuar informacionin kontabël të vitit 2025 për aktivitetin e Bashkisë Dimal.

Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimit financiar janë akt-rakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me degën e Thesarit, të konfirmuara dhe nënshkruara nga Nëpunësi Zbatues dhe Nëpunësi Autorizues, Specialisti i shpenzimeve, Specialisti i të Ardhurave i Degës së Thesarit për çdo institucion.

Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2025.

Për vitin 2025, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit me shkresën nr. 1065 prot.datë 30.03.2026, të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.
Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flou).
Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.
Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga hartuesi i llogarive vjetore znj. M. B. nëpunës zbatues dhe Kryetar i Bashkisë znj. J. M., Nëpunës autorizues.

Mbajtja e kontabilitetit v. 2023.

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale.
Gjëndja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2025, të pozicionit financiar Bashkia Dimal; Formati nr.1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:
Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2025, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim;

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet= 3,492,598,198 lekë.

Aktivet 4,088,741,740 lekë
Pasivet 596,143,542 lekë
Aktivet neto 3,492,598,198 lekë

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2025 paraqiten në vlerën **702,967,561 lekë** dhe përbëhen nga:
Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" në shumën 144,905,707 lekë,
Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 23,291,418 lekë,
Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" në shumën 407,111,541 lekë,
" Të tjera të arkëtueshme" në shumën 127,658,895 lekë.

Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
56	Mjete monetare ne bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	144,715,107	121,551,152	23,163,955
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	190,600	139,800	50,800
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provigjone zhvlerësimi	0	0	0
Totali		**144,905,707**	**122,676,867**	**22,228,840**

Vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" në shumën 144,715,107 lekë, sipas aktrakordimit me Thesarin datë 13.01.2026 dhe përbëhet nga gjendja e Llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në pasqyrën 1 "Pasqyra e pozicionit financiar" paraqitet në vlerën 82,953,000 lekë *(grandi papërdorur në vlerën 56,681,237 lekë, të ardhura të papërdorura në vlerën 26,225,576 lekë dhe sponsorizime në vlerën 46,188 lekë)* dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 61,762,106 lekë.
Nga auditimi ka rezultuar se gjendja e "Mjeteve monetare dhe ekuivalentet e tyre" e pasqyruar në mbyllje të vitit ushtrimor 2025, në vlerën 144,715,107 lekë rakordojnë me rubrikën VI "Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor" në Formatin nr.3 "Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte".
Llogaria 532 "Vlera të tjera" raportuar në bilanc për vlerën 190,600 lekë përfaqëson.*(pulla takse të Gjendej Civile në vlerën 131,000 lekë dhe bileta tregu në vlerën 59,600 lekë).*
Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
31	Materiale	4,301,816	2,688,137	1,613,679
32	Inventar i imet	18,989,602	17,845,059	1,144,543
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri	0	0	0
37	Gjendje te pambritura ose pranë të treteve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-)	0	0	0
	Totali	**23,291,418**	**20,533,196**	**2,758,222**

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Dimal në 31.12.2025 paraqitet në vlerën 23,291,418 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 4,301,816 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 "Inventar i imët" në vlerën 18,989,602 lekë. Diferencat me vitin e mëparshëm përfaqësojnë lëvizjen e inventarit në shumën (2,758,222) lekë e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi gjendjes së inventarit" në shumën 2,758,222 lekë.

Llogaria 312 "Materiale", ka vlerën 23,002,705 lekë vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	**2,688,137**
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025 (D)	34,414,874
Dalje nga magazina gjatë vitit	32,801,171
Gjendja në 31.12.2025	**4,301,816**

Llogaria 32 "Inventarë i imët", ka vlerën 31,428,366 lekë vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2025	**17,845,059**
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2025 (D)	2,230,967
Dalje nga magazina gjatë vitit 2025(K)	1,086,424
Gjendja në 31.12.2025	**18,989,602**

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

Inventarizimi i aktiveve:

Gjatë vitit 2025, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar dhe në UMFE nr. 30 datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*" nga ana e Kryetarit të Bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr. 900 datë 19.11.2025 i Kryetarit të Bashkisë, për ngritjen e komisionit të inventarizimit i përbërë me 5 anëtarë me afat përfundimi datë 05.12.2025.

Me urdhërin nr. 956, datë 12.12.2025 të Kryetarit të bashkisë është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve për jashtë përdorimit, i cili ka vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimit sipas procesverbalit datë 15.12.2025 aktivet si më poshtë:

Llogaria 32 "Inventarë ekonomik", për vlerën 1,086,424 lekë;

Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione” pemë dekorative në vlerën 182,440 lekë;
Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 1,640,800 lekë;
Llogaria 218 “Inventarë ekonomik” në vlerën 4,142,036 lekë.
Dhe ka paraqitur për miratim Këshillit të Bashkisë inventarët të vlerësuara për jashtë përdorimit, i cili me Vendimin nr. 23, datë 31.03.2026 është vendosur të miratojë vlerat e llogarive për nxjerrjen nga përdorimi për llogaritë si më poshtë:
Llogaria 32 “Inventarë ekonomik”, për vlerën 1,086,424 lekë;
Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione” pemë dekorative në vlerën 182,440 lekë;
Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në vlerën 1,640,800 lekë;
Llogaria 218 “Inventarë ekonomik” në vlerën 4,142,036 lekë.
Me urdhërin nr. 386, datë 04.05.2026 është ngritur komisioni i asgjësimit të aktiveve të miratuara për jashtë përdorimi i përbërë nga 5 anëtarë i cili me procesverbal nr. 1 prot., datë 08.05.2026 ka realizuar procesin e asgjësimit të inventarëve për të cilën për materiale plastike dhe lëkure janë groposur dhe për inventarë të cilat kanë përbërje metalike dhe druri janë bërë hyrje në magazinë me Fletë hyrje nr. 28, datë 08.05.2026 skrap me peshë 2795 lekë dhe dru zjarri 2.5 m^3. Rezultatet e inventarëve janë pasqyruar në pasqyrat financiare si paksime të gjendjeve të llogarive në fund të periudhës.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca 2025-2024
	Llogari të arkëtueshme	**407,111,541**	**386,048,290**	**21,063,251**
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	**3,260,853**	14,918,531	(11,657,678)
431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione te tjera publike	0	0	0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlere vendosjes	0	0	0
468	Debitorë te ndryshëm	346,178,661	310,270,664	35,907,997
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	56,686,112	60,859,095	(10,172,983)
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma te parashikuara për zhvleresim(-)	985,915	0	985,915
	Të tjera afat shkurtëra	**127,658,895**	**153,168,605**	**(25,509,710)**
486	Shpenzime të periudhave të ardhëshme	127,658,895	153,168,605	(25,509,710)

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 346,178,661 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2025	**310,270,664**
Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	121,155,275
Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	85,247,278
Gjendja në 31.12.2025	**346,178,661**

Vlera e debitorëve ne vitin 2025 në krahasim me vitin 2024 ka pësuar një rritje prej 35,907,997 lekë.

Analiza e gjendjes së llog. “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuara në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në pasqyrën më poshtë:

Debitorët analitikë.	**Çelja 01.01.2025**	**Shtesa gjatë vitit 2025 (debi)**	**Paksime gjatë vitit 2025 (kredi)**	**Gjendja me 31.12.2025**
Taksa lokale	309,907,303	61,894,920	44,549,921	327,252,302
Debitorë të KLSH	0	13,179,363	0	13,179,363

IVMT	0	43,624,950	38,400,000	5,224,950
Gjoba të policisë bashkiake	1,000	557,000	464,000	94,000
Debitorë çerdhe	138,178	825,222	833,177	130,223
Debitorë Kopështi	224,183	1,073,820	1,000,130	297,823
Shuma	**310,270,664**	**121,155,275**	**85,247,278**	**346,178,661**

Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)", në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerën 56,686,112 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, për detyrime paga, tatime taksa, sigurime shoqërore dhe fatura të palikujduara në fund të periudhës dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 56,106,512 lekë, ose më pak për vlerën 579,600 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që japin pasqyrat financiare në fund të periudhës.

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 "Aktivet Afatgjata Jo materiale", përbëhen nga llog.202 "Studime dhe kërkime", në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 29,476,350 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet si në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 77,716,016 lekë (viti 2024: 77,716,016 lekë). Për gjatë vitit 2025 nuk kemi shtesa e paksime. Gjendje e kësaj llogarie është analizuar për 26 objekte inventari me vlerë 77,716,016 lekë kosto historike, sipas të dhënave në pasqyrën **Aneks nr.1,** bashkëlidhur:

Konstatimi: Nga auditimi, konstatohet se llogaria 202 "Studime dhe projektime" në formatin Nr. 7/a paraqiten me koston historike në vlerën 77,716,016 lekë, e analizuar për 26 artikuj kontabël për studime e projektime. Nga verifikimi i inventarit kontabël u konstatua se në këtë llogari vlera prej 24,988,016 lekë i përket periudhave 2006-2009 për të cilat nuk ka dokumentacion për regjistrimin e saj në kontabilitet si dhe nuk ka informacion nëse ato janë vënë në zbatim për tu sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit, për pasojë në këtë rast pasqyrat financiare nuk e pasqyrojnë saktë vlerat e AAM, me ndikim në informacionin kontabël të tyre për efekt të llogaritjes së amortizimit, veprim në mospërputhje me Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 36.

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llog 210 "Toka,troje Terrene" paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2025, paraqiten në vlerën 0 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a "Gjëndja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025, paraqiten në vlerën 0 lekë (viti 2024: 0 lekë).

Llog 211 "Pyje, Kullota, Plantacione" në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 9,259,552 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 9,259,552 lekë (viti 2024: 8,729,192 lekë). Rezulton se gjatë vitit 2025 kjo llogari është shtuar për blerje me pagesë në vlerën 712,800 lekë, sipas kontratës nr. 36/12, datë 28.11.2025 për "Blerje pemë dekorative" me vlerë 712,800 lekë e cila është likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 804, datë 22.11.20225 me vlerë 712,800 lekë dhe është pakësuar për vlerën 182,440 lekë nga nxjerrjet jashtë përdorimit, sipas procesverbalit datë 31.12.2025, të miratuara me VKB nr. 23, datë 31.03.2026, për nxjerrjen jashtë përdorimit.

Kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 70 objekte me kosto historike në vlerën 9,259,552 lekë, të dhënat në pasqyrën **Aneks nr. 2,** bashkëlidhur.

Llog 212 "Ndërtesa konstruksione" në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 1,007,298,402 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,385,435,367 lekë (viti 2024: 1,127,645,422 lekë).
Gjatë vitit 2025 janë kapitalizuar aktive për blerje me pagesë në vlerën 257,789,945 lekë, nga të cilat të ardhura nga llogaria 231 "Investime në proces" në vlerën 241,676,059 lekë dhe diferenca në vlerën 16,113,886 lekë janë fatura të palikujduara për objektet të marra në dorëzim.
Kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 90 objekte me kosto historike në vlerën 9,259,552 lekë, të dhënat në pasqyrën **Aneks nr. 3,** bashkëlidhur.
Konstatimi : Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione" sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 1,385,435,367 lekë (viti 2024: 1,127,645,422 lekë). Referuar analizës së inventarit kontabël u konstatua se në fund të vitit nuk është zbritur vlera për 3 raste të investimeve për "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara" në shumën 51,011,257 lekë që nuk janë inventarë i Bashkisë, gjithashtu në këtë llogari nuk është zbritur vlera për 8 ndërtesa ambulanca në fshatrat Gorçan, Pashalli, Vokopolë, Skrevanj, Bistrovicë, Agim, Konizbaltye dhe Hinke në vlerën 9,415,294 lekë që janë objekte të cilat i përkasin DRSHSH duke mbivlerësuar llogarinë 212 "Ndërtesa e konstruksione" për vlerën 60,426,551 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 24 dhe 30.
Konstatimi; Referuar analizës regjistrit të aktiveve rezulton se, vlera e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve, janë regjistruar si aktive më vete pra nuk janë shtuar kostos fillestare të AAGJM-së, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me inventarin fizik, amortizimin dhe plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata, në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar , Kapitulli II, pika 5 dhe 11; Aneksin 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", pika 2 "Aktivet Afatgjata (Përbërja dhe trajtimi kontabël) germa (b)
Llog 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 2,030,374,269 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 2,495,873,577 lekë (viti 2024: 1,406,962,558 lekë).
Gjatë vitit 2025 janë kapitalizuar aktive për blerje me pagesë në vlerën 1,088,911,019 lekë, nga të cilat të ardhura nga llogaria 231 "Investime në proces" në vlerën 997,761,588 lekë dhe diferenca në vlerën 91,149,431 lekë janë fatura të palikujduara për objektet të marra në dorëzim.
Kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 213 objekte me kosto historike në vlerën 2,495,873,577 lekë, të dhënat në pasqyrën **Aneks nr. 4,** bashkëlidhur.
Konstatimi: Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 2,495,873,577 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël u konstatua se, nuk është zbritur vlera për 7 objekte për ujësjellës-kanalizimeve në shumën 400,430,489 lekë që duheshin transferuar Ujësjellës Kanalizime, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011

"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 24 dhe 30, të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

Objekte inventari të llog 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" për transferim në Ujësjellës kanalizime.

Nr	Objektet	Kosto historike 31.12.2025
1	Ndërtim KUZ Lagja 28 Nëntori viti 2020	16,353,900
2	Investim për ujësjellësin Guri I Bardhe dhe Pashalli viti 2024	12,000,000
3	Ndërtim Kuz Te Dafinat lagja 18 Tetori viti 2024	1,252,158
4	Ndërtimi I depos qendrore 500 m/3 si dhe rrjeti I brendshëm I ujësjellësit te fshatrave Kutalli , Gorican Qender , Gorican ,Clirim , Rerez Malas Breg te Komunes Kutalli viti 2025.	49,172,090
5	Rrjeti I shperndarjes Ura Vajgurore viti 2025	73,601,607
6	Rrjeti i brendshem dhe i jashtem Njesia CUKALAT Bashkia Ura Vajgurore + Supervizim viti 2025	241,807,934
7	Rrjeti I shperndarjes ne lagjen 18 Tetori dhe 4 Shtatori , furnizim me uje nga kaseta kolektivederi ne piken fundore te abonentit për lagjet 18 tetori dhe 4 shtatori viti 2025	6,242,800
	Totali	**400,430,489**

Konstatimi; Sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 llogaria 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" paraqitet në vlerën prej 2,495,873,577 lekë. Referuar analizës regjistrit të aktiveve rezulton se, vlerat e rikonstruksioneve të objekteve, vlera mbikëqyrjes dhe kolaudimit të objekteve, janë regjistruar si aktive më vete, nuk i janë shtuar vlerave të mëparshme, gjithashtu në inventarin kontabël të kësaj llogarie kemi vlerën prej 96,994,413 lekë të paanalizuar me objekte, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me inventarin fizik, amortizimin dhe plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar , Kapitulli II, pika 5 dhe 11; Aneksin 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", pika 2 "Aktivet Afatgjata (Përbërja dhe trajtimi kontabël) germa (b)

Llog 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 5,324,303 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 21,169,937 lekë (viti 2024: 20,307,537 lekë). Rezulton se gjatë vitit 2025 kjo llogari është shtuar për blerje me pagesë në vlerën 2,503,200 lekë, sipas kontratës nr. 521/21, datë 22.04.2025 për "Blerje kontenierë pastrimi" me vlerë 2,503,200 lekë e cila është likuiduar pjesërisht me Urdhër shpenzimi nr. 889, datë 31.12.20225 në vlerën 1,500,000 lekë dhe është pakësuar për vlerën 1,640,800 lekë nga nxjerrjet jashtë përdorimit, sipas procesverbalit datë 31.12.2025, të miratuara me VKB nr. 23, datë 31.03.2026, për nxjerrjen jashtë përdorimit.
Kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 39 objekte me kosto historike në vlerën 21,169,973 lekë, të dhënat në pasqyrën **Aneks nr. 5,** bashkëlidhur.
Llogaria 215 "Mjete transporti" në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2025 në shumën prej 29,413,951 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 90,589,613 lekë (viti 2024: 78,805,613 lekë).
Rezulton se gjatë vitit 2025 kjo llogari është shtuar për blerje me pagesë në vlerën 11,784,000 lekë sipas kontratës nr. 2384/18, datë 22.10.2025 për "Blerje mjeti" me vlerë 11,784,000 lekë e

cila është likuiduar pjesërisht me Urdhër shpenzimi nr. 685, datë 20.11.20225 në vlerën 6,000,000 lekë dhe Urdhër shpenzimi nr. 777, datë 28.12.2025 në vlerën 720,000 lekë.
Kjo llogari është e analizuar në kontabilitet për 24 mjete me kosto historike në vlerën 90,589,613 lekë, të dhënat në pasqyrën **Aneks nr. 6,** bashkëlidhur.
Llogaria kontabël 218 "Inventar ekonomik". Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative të Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarisë 218 *"Inventar ekonomik"* në vlerën neto paraqitet në mbyllje të të vitit 2025 në vlerën 45,586,438 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 102,504,106 lekë (viti 2024: 89,151,297 lekë). Rezulton se gjatë vitit 2025 kjo llogari është shtuar për blerje me pagesë në vlerën 535,000 lekë dhe nga jashtë sistemit në vlerën 16,959,845 lekë dhe pakësuar për vlerën 4,142,036 lekë nga nxjerrjet jashtë përdorimit, nga nxjerrjet jashtë përdorimit, sipas procesverbalit datë 31.12.2025, të miratuara me VKB nr. 23, datë 31.03.2026, për nxjerrjen jashtë përdorimit.
Llogaria 218 "Inventarë ekonomik" sipas inventarit kontabël, është e analizuar për zyrat e bashkisë, njësitë administrative dhe shkollat në pasqyrën me të dhënat si më poshtë:

Nr	Institucionet	Vlera kosto historike
1	Zyrat e Bashkisë	12,858,961
2	Zyrat e Njesise Poshnje	2,383,095
3	Zyrat e Njesise Kutalli	2,002,337
4	Zyrat e Njesise Cukalat	999,854
5	Arsimi Ure Vajgurore	32,748,413
6	Arsimi Poshnje	18,649,956
7	Arsimi Kutalli	21,074,143
8	Arsimi Cukalate	3,848,773
9	Kulltura dhe cerdhe	6,734,521
10	Sektori I sherbimeve	689,705
11	Zjarrfikese	64,200
12	Furnizimi Dhjetor	450,148
	TOTALI	**102,504,106**

Llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet" paraqitet në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 147,176,127 lekë, e cila përfaqëson, vlerën e aksioneve të Bashkisë në UK Dimal.
Llogaria 231 "AAGJM Investime në proces" paraqitet në mbyllje të vitit 2024, në vlerën 1,056,728,677 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 81,862,787 lekë, të cilat përfaqësojnë investime për kontrata të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimorë 2025.
Analiza e këtyre investimeve sipas llogarive dhe kontratave paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Analiza e llogarise 231 "AAGJM Investime në proces", sipas objekteve.	Kontrata			Likujdime deri me 31.12.2025
	Nr	datë	vlera	
Ndërtim kanalesh vaditës fshati Goriçan	1597/33	11,09,2024	44,886,312	39,517,535
Vazhdimin e shtresës asfaltike në rrugën "Andon Zako Çajupi" në fshatin Hingë	1257/18	10.10.2025	11,088,660	2,300,000
Rikonstruksion rruga "Pleshivës" fshati Rërëz.	1258/20	03.11.2025	48,528,852	10.000,000
Rikonstruksion rrugësh me rërë bituminoze në fshatrat Poshnje, Velaj dhe Allambresë dhe asfalt "Paqeruajtësit" Bashkia Dimal.	1259/22	19.11.2025	20,663,736	4,400,000
Përmirësim I banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara 2025	2352/18	03.10.2025	21,869,978	7,949,024
Rikonstruksion I shkollës 5 Maji dhe ndërtim palestre	2223/21	23.10.2025	84,026,139	17,696,228
Totali				**81,862,787**

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Dimal më 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2025, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2025	Viti 2024	Diferenca/ndryshimi
	Llogari të pagueshme	**245,718,113**	**269,312,182**	**23,594,069**
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	31,370,493	36,129,744	(4,759,251)
42	Detyrime ndaj personelit	17,462,143	17,489,244	(27,101)
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	1,332,539	1,280,002	52,537
435	Sigurime shoqërore	5,113,237	5,131,081	(17,844)
436	Sigurime shëndetësore	703,900	704,824	(924)
437,438	Organizma të tjerë shtetrorë(tatim në burim)	124,200	124,200	0
464	Detyrime për tu paguar për blerje letrave me vl	190,600	139,800	50,800
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	61,762,106	55,144,682	6,617,424
467	Kreditorë të ndryshëm	127,658,895	153,168,605	(25,509,710)

Llogaria 401-408 "Furnitor e llogari të lidhura me to", paraqiten detyrimet për fatura të palikujduara për muajt nëntor dhjetorë të vitit 2025 në vlerën 31,370,793 lekë, në mënyrë analitike paraqiten në pasqyrën **Aneks nr. 7,** bashkëlidhur.

Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit", sipas pasqyrave financiare, paraqitet në vlerën 17,462,143 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llog. 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Çelje e vitit 2025	**17,489,244**
Shtesa (K)	205,697,256
Pakësime (D)	205,724,357
Gjendja në 31.12.2025	**17,462,143**

Llogaria 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa", paraqitet në vlerën 1,332,539 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2025	**1,280,002**
Shtesa (K)	17,523,234
Pakësime (D)	17,470,697
Gjendja në 31.12.2025	**1,332,539**

Llogaria 435, "Sigurime shoqërore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2025, në vlerën 5,113,237 lekë.

Llog. 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2025	**5,131,081**
Shtesa (K)	60,946,096
Pakësime (D)	60,963,940
Gjendja në 31.12.2025	**5,113,237**

Llogaria 436 "Sigurime shëndetësore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2025, në vlerën 703,900 lekë.

Llog. 436 "Sigurime shëndetësore"	
Çelje e vitit 2025	**704,624**
Shtesa (K)	8,395,948
Pakësime (D)	8,396,672
Gjendja në 31.12.2025	**703,900**

Llogaria 466 "Kreditore për mjete nën ruajtje", përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 55,144,682 lekë dhe në mbyllje të vitit 2025 në vlerën 61,762,106 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit në mënyrë analitike, e cila paraqitet, në pasqyrën **Aneks nr. 8,** bashkëlidhur.

Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", paraqiten detyrimet për fatura të palikujduara për vitin 2025 paraqiten në vlerën 127,658,895 lekë, në mënyrë analitike paraqiten në pasqyrën **Aneks nr. 9,** bashkëlidhur.

Analizë: Formati nr.2 "Pasqyra e performancës financiare" paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2025, të cilat në total janë në vlerën 714,478,848 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Berat paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike ***70*** **"Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 90,863,718 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 95,746,837 lekë, me rritje në vlerën 4,883,119 lekë.

70	***I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET***	**95,746,837**	**90,863,718**
700	**1.Tatimi mbi te Ardhurat**	**65,762**	**47,986**
7000	Tatim mbi te ardhurat personale	0	0
7001	Tatim mbi Fitimin	0	0
7002	Tatim mbi Biznesin e vogël	65,762	47,986
7009	*Te tjera Tatime mbi te ardhurat*	0	0
702	**2.Tatimi mbi Pasurinë**	**52,407,942**	**52,804,831**
7020	Tatim mbi Pasurinë e palujtshme	52,407,942	52,804,831
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë se palujtshe	0	0
7029	Te tjera tatime mbi Pasurinë	0	0
703	**3.Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit**	**43,251,487**	**37,959,450**
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar(TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Takse mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Takse mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	0	0
7035	Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	43,251,487	37,959,450

Referuar të dhënave të akt rakordimit të të ardhurave me Degën e Thesarit datë 02.02.2026 kemi informacioni si mëposhtë:

1) Sipas kodifikimit 700 *" Tatim mbi të ardhurat"* e cila është kontabilizuar për vlerën 65,762 lekë janë përfshirë.

-Tatim mbi biznesin e vogël me vlerë 65,762 lekë.

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 700 *"Tatim mbi të ardhurat"* rakordojn me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin.

2) Sipas kodifikimit 702 *"Tatim mbi Pasuritë"* e cila është kontabilizuar për vlerën 52,407,942 lekë janë përfshirë.

a)Tatim mbi pasuritë e paluajtshme me vlerë 52,407,942 lekë;

Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7020 *"Tatim mbi Pasuritë e Paluajtshme"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:

-Taksa e ndërtesës me vlerë 26,468,841 lekë;

-Taksë mbi tokën bujqësore me vlerë 22,825,327 lekë;

-Taksë trualli me vlerë 3,113,774 lekë;

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7020 *"Tatim mbi Pasuritë e Paluajtshme"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin.

3) Sipas kodifikimit 703 *"Tatim mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit"* e cila është kontabilizuar për vlerën 43,251,487 lekë janë përfshirë.

a)Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie (7035) me vlerë 43,251,487 lekë.

Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7035 *"Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:

-Taksë vendore regjistrim biznesi me vlerë 768,021 lekë;
-Taksë për zënien e hapësirës publike me vlerë 1,325,392 lekë;
-Taksë e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe legalizimet me vlerë 11,087,658 lekë;
-Taksë vendore e gjelbërimit me vlerë 6,993,416 lekë;
-Taksë vendore për dhënie licence për tregtim karburanti me vlerë 5,300,000 lekë;
-Taksë vendore për urbanistikën me vlerë 2,906,443 lekë;
-Tarifë për kullotat me vlerë 19,900 lekë;
-Taksë vendore për reklamat me vlerë 798,915 lekë;
-Taksë vendore e tabelës me vlerë 409,784 lekë;
-Tarifë vendore për ndriçimin me vlerë 6,373,868 lekë;
-Tarifë për ndotje me vlerë 7,242,690 lekë;
-Taksë vendore për fjetjen në hotel me vlerë 25,400 lekë;

Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7035 *"Tatim mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kod sipas akt rakordimit me thesarin.

2. Të ardhurat jo tatimore:

Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 70,294,954 lekë ndërsa në datën 31,12,2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 76,116,967 lekë ose me shtesë në vlerën 5,822,013 lekë.

Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën në vijim:

lekë

71	***III.TE ARDHURA JO TATIMORE***	**76,116,967**	**70,294,954**
710	**1.Nga ndërmarrjet dhe pronësia**	**2,021,598**	**1,123,018**
7100	Nga Ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga Ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Te tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	2,021,598	1,123,018
711	**2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare**	**74,095,369**	**69,171,936**
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	66,517,094	61,476,429
7111	Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	4,476,064	4,254,384
7112	Takse për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	170,000	99,000
7114	Te ardhura nga biletat		
7115	Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	2,932,211	3,342,124
7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	**3.Te tjera te ardhura jo tatimore**	0	0

1) Sipas kodifikimit 710 *"Tatim nga ndërmarrjet dhe pronësia"* e cila është kontabilizuar për vlerën 2,021,598 lekë janë përfshirë.

a)Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia (7109) me vlerë 2,021,598 lekë;

Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7109 *"Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:

-Të ardhura nga qeratë për toka bujqësore me vlerë 986,148 lekë;
-Të ardhura nga pyje e kullota me vlerë 971,500 lekë;

-Qira ndërtese me vlerë 63,950 lekë.
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 710 *"Tatim nga ndërmarrjet dhe pronësia"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.
2) Sipas kodifikimit 711*"Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare"* e cila është kontabilizuar për vlerën 74,095,369 lekë janë përfshirë.
a)Tarifa administrative dhe rregullatorë (7110) me vlerë 66,517,094 lekë;
b)Të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh (7111) me vlerë 4,476,064 lekë;
c)Të tjera të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve (7113) me vlerë 170,000 lekë;
d)Të ardhura nga gjoba kamatëvonesa e sekuestrime (7115) me vlerë 2,932,211 lekë;
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7110 *"Tarifa administrative dhe rregullatorë"* janë përfshirë taksat si mëposhtë:
-Tarifë për akte administrative me vlerë 40,100 lekë;
-Tarifa për leje transporti me vlerë 1,912,386 lekë;
-Tarifë rrugore me vlerë 20,393,539 lekë;
-Tarifë kanalizimet me vlerë 800 lekë;
-Tarifë për ujitje dhe kullimin me vlerë 8,009,943
-Tarifë pastrimi dhe higjene me vlerë 31,889,280 lekë;
-Tarifa arsimore me vlerë 4,271,046 lekë;
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7110 *"Tarifa administrative dhe rregullatorë"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7111 *"Të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh"* janë përfshirë taksat si më poshtë:
-Tarifë kopshte me vlerë 92,500 lekë;
-Tarifë çerdhe me vlerë 1,854,757 lekë;
-Të ardhura nga parkingu me vlerë 2,528,807 lekë;
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7111 *"Të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7113 *"Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve* janë përfshirë taksat si më poshtë:
-Të ardhura nga MNZ me vlerë 170,000 lekë;
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7113 *"Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.
Në taksat e kontabilizuara me kodifikim 7115 *"Të ardhura nga gjoba kamatëvonesa e sekuestrime*" janë përfshirë taksat si më poshtë:
-Të tjera gjoba me vlerë 2,067,919 lekë;
- Kamatëvonesa me vlerë 691,550 lekë;
-Gjoba të Policisë Bashkiake me vlerë 151,000 lekë;
-Sekuestrime dhe zhdëmtime me vlerë 21,742 lekë;
Referuar informacionit të mësipërm taksat e kontabilizuara sipas kodifikimit 7115 *"Të ardhura nga gjoba kamatëvonesa e sekuestrime"* rakordojnë me taksat e përfshira në këtë kodi sipas akt rakordimit me thesarin.
3. Grante korente:
-Llogaria 72 "Grante korente", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 455,659,149 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 542,615,045 lekë ose me një rritje në vlerën 86,955,896 lekë.
Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
72	**V. GRANTE KORENTE**	**542,615,045**	**455,659,149**
720	**1. Grant korent i brendshëm**	**542,615,045**	**455,659,149**
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	0	0
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	443,396,800	360,302,324
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	43,111,733	34,497,730
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	0	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	56,106,512	60,859,095
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	0	0
7209	Të tjera grante korente të brendshme	0	0

<u>Analiza e shpenzimeve</u> në vitin 2025 , të cilat në total janë në vlerën 565,659,969 lekë paraqitet më poshtë:

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve" në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 219,833,337 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie është raportuar 251,946,843 lekë ose me një rritje në vlerën 32,113,506 lekë.

-Llogaria 601 "Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 36,183,620 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie është raportuar 40,373,841 lekë ose me një rritje në vlerën 4,190,221 lekë.

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 "Blerje mallra dhe shërbime", në datë 31.12.2024, ka qenë në vlerën 119,410,644 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie është raportuar në vlerën 113,249,121 lekë ose me ulje në vlerën 6,161,523 lekë.

3. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve 604 "Transferime korrente të brendshme" paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 4,801,427 lekë dhe për vitin 2025 në vlerën 658 lekë Gjendja e llogarisë së fondeve 606 "Transferime për Buxhetet familjare e Individë" paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 170,390,178 lekë dhe për vitin 2025 në vlerën 162,847,728 lekë ose me ulje për vlerën 7,542,450 lekë.

Për vitin 2025 totali i të ardhurave në vlerë është 714,478,848 lekë dhe totali shpenzimeve është 565,659,969 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 148,818,879 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 "Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor" në vlerën 148,818,879 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit për likuidimin e kontratave për investime dhe blejë mallrash e shërbimesh, rezultoi se bashkëlidhur urdhër shpenzimeve, referuar kontratave, ndodhej i gjithë dokumentacioni ligjor bashkëshoqërues, në përputhje me kërkesat e pikave 34 dhe 35, të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, dhe pikës 2.2 të Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", i ndryshuar, si më poshtë vijon:

- Urdhër prokurimi;
- Kontrata bazë në të cilën janë të përcaktuar vlera e kontratës, data e fillimit dhe mbarimit;
- Amendament shtesë kontrate në rastet kur është kërkuar shtesë për afat përfundimi;
- Urdhër shpenzimi për likuidimin e faturave;
- Urdhëri për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim si të mallit dhe të investimeve;
- Fletë hyrjes në rastet e kontratave për blerje malli;
- Procesverbal i komisionit të marrjes në dorëzim të kontratave blerje malli;
- Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim e kontratave për investime;

- Akt-kolaudim përfundimtar në rastet e likuidimit të përfundimit të garancisë së punimeve, etj.;

Nga auditimi, rezultoi se kryerja e shpenzimeve është bërë në përputhje me Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.20218 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar.

Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik, pika 6 ku cilësohet:

"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues, të cilët dallohen në:

- *Dokumente bazë justifikues (faturë blerje/shitje, fletë-hyrje/dalje, mandat-arkëtim/ pagesë), të prodhuara manualisht ose nëpërmjet programeve informatike, dhe shërbejnë për kryerjen e regjistrimeve fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik në librat e kontabilitetit.*
- *Urdhër-shpenzimi/Urdhër-pagesa që përdoren në marrëdhëniet e njësive të qeverisjes së përgjithshme me degën përkatëse të thesarit, për paraqitjen e kërkesave për kryerjen e një shpenzimi apo ekzekutimin e një pagese, nëpërmjet Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ).*
- *Libra kontabiliteti, ditarë kontabilitetisi dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet.*
- *Dokumente të tjerë kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme".*

Si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2013 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" cilësohet:

"Pika 35. *Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:*

a. *Dokumente autorizuese - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.*

b. *Dokumente vërtetuese - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.*

c. *Dokumente të kontabilitetit - janë dokumentet përmbledhëse, ose regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitikë, kartelat e aktiveve, etj.) të çdo lloj forme, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.*

Pika 36. *Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve".*

IV. REKOMANDIME.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, rezultoi: Mungesa e trajnimit të stafit të bashkisë, mos miratimi të planeve vjetore të punës për funksionimin e GMS, mos miratimi i planit të përgjithshëm strategjik, mungesa e

hartimit dhe miratimit të strategjisë së menaxhimit të riskut; mungesa e gjurmëve të auditimit për proceset e ndjekura. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 "Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin" nenet 20, 21, 22, 23 dhe 24. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 1, faqe 13-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Titullari i njësisë vendore për mirëfunksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të marrë masa si vijon:

-Të hartohet një plan trajnimesh për punonjësit e këtij institucioni;
- Të hartohet dhe miratohet Plani Strategjik i institucionit;
- Të hartohet dhe miratohet strategjia e menaxhimit të riskut;
- Të miratohet Gjurma e Auditimit për institucionin.

Menjëherë.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Dimal përgjatë vitit 2025, u konstatua se:

-Struktura e projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare pjesë e dosjeve të auditimit të zhvilluar në vitin 2025, nuk është hartuar plotësisht në përputhje me Urdhrin nr. 4, datë 10.10.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

-Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore.

-Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka çelur manualisht dhe elektronikisht dosjet e përhershme mbi njësitë e menaxhimit.

-Në dosjet e auditimit të realizuar nga Njësia e Auditimit nuk është dokumentuar plani i veprimit, i cili duhet të realizohet nga subjekti i audituar në funksion të zbatimit rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 13, Urdhri nr. 4, datë 10.10.2020 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Normave Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 19 pika 1, Manuali i Auditimit të Brendshëm. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 1, faqe 13-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm të marrë masa:

-Për çeljen manualisht dhe elektronikisht të dosjeve të përhershme të auditimit të sektorëve dhe drejtorive të institucionit.

-Të arkivojë dosjet e auditimit në përfundim të çdo misioni auditimi në arkivin e institucionit.

Menjëherë.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të buxhetit, bazuar në aktakordimin me Degën e Thesarit për periudhën objekt auditimi, rezultoi se nga fondet buxhetore të planifikuara në vlerën **991,952 mijë lekë**, janë realizuar shpenzime në vlerën **860,112 mijë lekë**, ose **87%**, duke rezultuar me mosrealizim në vlerën **131,840 mijë lekë**. Nga analiza sipas kategorive të shpenzimeve rezultoi se mosrealizimi është i ndjeshëm veçanërisht në shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime. Konkretisht, për shpenzimet operative, nga 158,927 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 123,752 mijë lekë, ose 78%, me një mosrealizim në vlerën 35,175 mijë lekë. Ndërsa, për shpenzimet për investime, nga 357,688 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 281,379 mijë lekë, ose 79%, me një mosrealizim në vlerën 76,309 mijë lekë.

Mosrealizimi i shpenzimeve buxhetore ka ardhur, ndër të tjera, si pasojë e mosrealizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore dhe lidhjes me vonesë të kontratave, duke ndikuar në realizimin në kohë të shpenzimeve të planifikuara.

Në këto kushte, niveli i realizimit të shpenzimeve operative dhe veçanërisht i shpenzimeve për investime është më i ulët se niveli mesatar i realizimit të buxhetit në tërësi (87%), çka tregon për mangësi në procesin e planifikimit dhe të realizimit në kohë të programit buxhetor.

Këto mangësi kanë ndikuar në përdorimin jo të plotë të fondeve të planifikuara dhe në realizimin me vonesë të aktiviteteve dhe investimeve të parashikuara, me ndikim potencial në funksionimin

e shërbimeve publike dhe në ofrimin në kohë dhe me cilësi të të mirave dhe shërbimeve ndaj komunitetit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*", i ndryshuar neni 5, germa **"a".** *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 2, faqe 24-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomisë Financës dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Dimal, gjatë hartimit të buxhetit vjetor dhe programeve buxhetore afatmesëm, të bazohet në parashikimet reale të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të vitit të mëparshëm, duke pasur në konsideratë mosrealizimin e të ardhurave dhe analizimin e faktorëve që kanë ndikuar në mosrealizimin e shpenzimeve, kryesisht të shpenzimeve operative dhe ato për investime.

Në vijimësi.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se detyrime për fatura të pa likuiduara dhe vendime gjykate të raportuara ne MFE në fund të vitit me shkresën nr. 794 Prot., datë 02.03.2026 "Mbi raportin e monitorimit për 12/mujorin e vitit 2025", janë për vlerën 121,365,754 lekë *(shpenzime mirëmbajtje, shërbime e mallra në vlerën 46,753,969 lekë, shpenzime kapitale në vlerën 62,746,764 lekë dhe shpenzime gjyqësore në vlerën 11,865,021 lekë),* në raport me shpenzimet e kryera zënë 19.41% të tyre. Nga verifikimi i faturave të palikuiduara u konstatua se nuk është ndjekur radha e pagesës për 32 fatura në vlerën 76,280,605 lekë. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 41, me ligjin nr. 68/2017 datën 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 40,42. Udhëzimin i MFE nr. 9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 106, Udhëzimin e MF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", Kreu ", pikat 82-91. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 2, faqe 24-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomisë Financës dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Dimal të marrë masa për të paraqitur në mbledhjen e Këshillit Bashkiak një material të detajuar mbi gjendjen aktuale të faturave të palikuiduara, në vlerën prej 121,365,754 lekë. Gjithashtu, të hartojë një plan për likuidimin e këtyre detyrimeve, duke respektuar rendin kronologjik të pagesave, me përparësi për detyrimet e krijuara përpara vitit buxhetor, me qëllim shmangien e kostove shtesë për buxhetin, të shkaktuara nga vonesat në pagesa.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se llogaria 202 "Studime dhe projektime" në formatin Nr. 7/a paraqiten me koston historike në vlerën 77,716,016 lekë, e analizuar për 26 artikuj kontabël për studime e projektime. Nga verifikimi i inventarit kontabël u konstatua se në këtë llogari vlera prej 24,988,016 lekë i përket periudhave 2006-2009 për të cilat nuk ka dokumentacion për regjistrimin e saj në kontabilitet, si dhe nuk ka informacion nëse ato janë vënë në zbatim për tu sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit, për pasojë në këtë rast pasqyrat financiare nuk e pasqyrojnë saktë vlerat e AAM, me ndikim në informacionin kontabël të tyre për efekt të llogaritjes së amortizimit. Veprime në mospërputhje me Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 36 . *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 3, faqe 33-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomisë Financës dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Dimal të marrë masa për kryerjen e sistemimeve kontabël në lidhje me pasqyrimin si pjesë të AAMGJ të të gjithë elementëve të tyre përfshirë dhe vlerën e studim projektimeve.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione" sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 gjendja paraqitet në vlerën 1,385,435,367 lekë (viti 2024: 1,127,645,422 lekë). Referuar analizës së inventarit kontabël u konstatua se në fund të vitit vlera për 3 raste të investimeve të përfunduara në vitin ushtrimor me objekt "Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara" në shumën 51,011,257 lekë është paraqitur si inventarë i Bashkisë, gjithashtu në këtë llogari nuk është zbritur vlera për 8 ndërtesa ambulanca në fshatrat Gorçan, Pashalli, Vokopolë, Skrevanj, Bistrovicë, Agim, Konizbalte dhe Hinke në vlerën 9,415,294 lekë, që janë objekte të cilat i përkasin Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Berat, duke mbivlerësuar llogarinë 212 "Ndërtesa e konstruksione" për vlerën 60,426,551 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 24 dhe 30. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 3, faqe 33-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomisë Financës dhe Menaxhimit të Aseteve, Bashkia Dimal të marrë masa për kryerjen e sistemimeve kontabël duke zbritur vlerën e investimeve për objekte që nuk janë inventarë i saj në shumën 51,011,257 lekë.

Menjëherë

6.2. Rekomandimi: Bashkia Dimal, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për transferimin në Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Berat të 8 artikujve kontabël ndërtesa pjesë e inventarit me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur vlerën 9,415,294 lekë.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2025 paraqitet në vlerën 2,495,873,577 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël u konstatua se, nuk është zbritur vlera për 7 objekte për ujësjellës-kanalizimeve në shumën 400,430,489 lekë, që duheshin transferuar Ujësjellës Kanalizime, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 24 dhe 30 . *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 3, faqe 33-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Bashkia Dimal, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për transferimin në shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" sh.a të 7 artikujve kontabël pjesë e inventarit me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryhen veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur vlerën 400,430,489 lekë.

Në vijimësi

B. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve Drejtoria e Taksave dhe Sektori Borxhit edhe pse ka zbatuar përcaktimet në Kreun XI "*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar*", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, u konstatua se në fund të periudhës janë debitorë progresiv 117 subjekte për vlerën 40,247,940 lekë *(nga kjo debitorë të vitit 2025 janë shtuar për vlerën 5,097,008 lekë)* të dhënat në pasqyrën Aneks nr. 2, bashkëlidhur dhe debitorë progresiv familjarë janë 4595 familje për vlerën 225,504,530 lekë *(nga kjo debitorë të vitit 2025 janë shtuar për vlerën 46,823,854 lekë)*. Debitorët gjithsej në fund të periudhës të kontabilizuar janë për vlerën 265,752,470 lekë, **nga e cila vlera prej 51,920,862 lekë** përfaqësojnë detyrime debitore të krijuara gjatë vitit 2025**,** të cilat përbëjnë **të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.** *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 2, faqe 24-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Sektori i Borxhit, Bashkia Dimal të marrë masa për zbatimin procedurat ligjore për arkëtimin e debitorëve progresiv për taksa e tarifa vendore për 117 subjekte të biznesit të madh e të vogël dhe për 4595 familje, me vlerë 265,752,470 lekë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur me administrimin dhe arkëtimin e detyrimeve për qiratë e tokave bujqësore, rezultoi se Drejtoria e Taksave dhe Sektori i Borxhit kanë ndjekur, në përgjithësi, përcaktimet e kontratave të qirasë lidhur me detyrimet e qiramarrësve dhe afatet/mënyrën e likuidimit të tyre. Megjithatë, nga verifikimi i gjendjes së debitorëve rezultoi se, në fillim të vitit 2025, detyrimet e prapambetura nga qiratë e tokave bujqësore ishin në vlerën **14,439,742 lekë**. Gjatë vitit 2025, nga këto detyrime është arkëtuar vlera **566,568 lekë**, ndërkohë që detyrimet e paarkëtuara janë shtuar me vlerën **2,511,742 lekë**. Si rezultat, në fund të periudhës, gjendja debitore progresive e kontabilizuar për **39 kontrata qiraje** rezulton në vlerën **16,384,916 lekë**. Nga analiza e të dhënave rezulton se vlera prej **2,511,742 lekë**, e krijuar dhe e paarkëtuar gjatë vitit 2025, përbën **të ardhura të parealizuara për buxhetin e Bashkisë**, si pasojë e moslikuidimit në afat të detyrimeve kontraktore nga qiramarrësit. Mosarkëtimi në kohë i këtyre detyrimeve ka sjellë rritjen e stokut të debitorëve dhe ka ndikuar në realizimin e të ardhurave të planifikuara të Bashkisë nga dhënia me qira e tokave bujqësore. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin" i ndryshuar neni 12, germa **"g"** dhe kushteve të kontratës. *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 2, faqe 24-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Bashkia Dimal nëpërmjet Drejtoria e Taksave dhe Sektori i Borxhit dhe Drejtorisë Juridike, të marrë masa për zbatimin procedurat ligjore për arkëtimin e debitorëve progresiv për dhënie me qira toka bujqësore, për 39 kontrata qiraje me vlerë 16,384,916 lekë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, Drejtoria e Taksave dhe Sektori Borxhit edhe pse ka zbatuar përcaktimet ligjore të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit*

në infrastrukturë, pika 3/c, rezulton se në fillim të vitit 2025 debitorë kanë qenë për vlerën 5,516,143 lekë për gjatë vitit 2025 nuk kanë likuiduar detyrimet në shumën 3,980,449 lekë dhe janë arkëtuar detyrime ë vlerën 3,234,277 lekë, pra debitorët progresiv gjithsej në fund të periudhës të kontabilizuar janë për **219 objekte të personave** në vlerën 6,262,316 lekë, **nga e cila vlera prej 3,980,449 lekë** shtuar gjatë vitit 2025 **janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.** *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 2, faqe 24-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Sektori i Borxhit, Bashkia Dimal, të marrë masa për zbatimin procedurat ligjore për arkëtimin e debitorëve progresiv për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit për 219 persona me vlerë 6,262,316 lekë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me pagesën e detyrimeve për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, Drejtoria e Taksave dhe Sektori Borxhit edhe pse ka zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 35, të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", i ndryshuar, rezultoi se nuk kanë likuiduar detyrimet subjekti "D. O." ShPK në vlerën 800,000 lekë, subjekti "A." ShPK në vlerën 1,000,000 lekë dhe subjekti "2. Sh." Poshnje në vlerën 400,00 lekë, gjithsej **në vlerën 2,200,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë.** *(Më hollësisht janë trajtuar në pikën 2, faqe 24-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Sektori i Borxhit, Bashkia Dimal, të marrë masa për zbatimin procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara për pajisjen me Autorizim/Liçensë për shitje karburanti nga 3 subjekte të vlerës 2,200,000 lekë.

Menjëherë

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT